REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 dhjetor 2023
Nr.ref.: AGJ 2306/23

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI74/22

Parashtrues

Zoran Đokić

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml.nr.19/2022 të 15 shkurtit 2022

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Zoran Đokić (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) përfaqësuar nga Ljubomir Pantoviq, avokat nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Pml.nr.19/2022] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 15 shkurtit 2022 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [APS.nr.22/2021] të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës të 12 tetorit 2021 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë [ST.nr.15/19] të 11 shkurtit 2021 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetutës) në lidhje me nenin 6 (3) (a) dhe (d) (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) dhe nenin 9 (2) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj (në tekstin e mëtejmë: KNDCP).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 (1) dhe (7) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

5. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri ne fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 31 maj 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 8 qershor 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes vendimit GJR. Nr. KI74/22 caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).

8. Më 8 qershor 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.

9. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dhe betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç 'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

10. Më 7 nëntor 2023, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës dhe vlerësim në merita.

11. Të njëjtën ditë, Gjykata votoi, njëzëri që kërkesa është e pranueshme; dhe me shumicë, se nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (3) (a) dhe (d) (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhje e fakteve

12. Më 31 maj 2019, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Prokuroria Speciale) ka ngritur aktakuzë PPS.nr.23/2018, kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të veprës penale Krime lufte që përbënë shkelje të rëndë të nenit 3 të Konventave të Gjenevës, në pajtim me nenin 152 paragrafi 1 Ligjit penal të Kosovës dhe nenit 142 të Ligjit penal të RSFJ-së, krimet e luftës përbëjnë shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konflikte të armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar që ndiqen në bazë të nenit 153, paragrafi 1 nën paragrafi 2.1,2.2,2.5,2.8, 2.13 dhe nenit 3 të Ligjit penal të Kosovës.

13. Gjykata Themelore kishte caktuar dhe mbajtur seancën fillestare, ku në fillim parashtruesit të kërkesës i është lexuar aktakuza, pasi që kryetari i kolegjit ka vërtetuar se parashtruesi i kërkesës ka kuptuar përmbajtjen e aktakuzës, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet - i fajshëm ose i pafajshëm.

14. Parashtruesi i kërkesës ishte deklaruar se është i pafajshëm për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza.

15. Më 8 janar 2021, Prokuroria Speciale e ndryshoi dhe zgjeroi aktakuzën PPS.nr.23/2018 të 31 majit 2019 duke arsyetuar "*gjatë shqyrtimit gjyqësor, provat e ekzaminuara kanë dëshmuar se gjendja faktike e paraqitur në aktakuzë është ndryshuar, e në anën tjetër me zbatimin e provave gjatë shqyrtimit gjyqësor, është zbuluar se i akuzuari Zoran Đokić, ka kryer edhe një vepër penale, në bazë të dispozitave të neneve 350, paragrafi 1 dhe 351, paragrafi 1 i KPK-së.*"

16. Ndryshimi i aktakuzës kishte të bënte me periudhën mars-prill të vitit 1999 që ngarkonte parashtruesin e kërkesës me akuzën se në bashkëkryerje me persona tjerë ka shkuar në Lagjen "Kristal" në Pejë, dhe ka marrë pjesë në aksionin i cili ka filluar për vrasjen dhe dëbimin e popullatës shqiptare nga shtëpitë e tyre.

17. Zgjerimi i aktakuzës për periudhën mars-prill të vitit 1999 e ngarkonte parashtruesin e kërkesës: "*Gjatë muajit mars-prill të vitit 1999, përkatësisht me 28.03.1999, në Lagjen "Te Soliteri" e cila tani quhet "Rrokaqielli", në Pejë, në bashkëkryerje me grupin e organizuar kriminal të kombësisë Serbe, në mesin e të cilëve ishte edhe personi i quajtur S dhe NN persona të paidentifikuar deri më tani, në uniforma të policisë, forcave paramilitare dhe të ushtrisë, u kanë shkaktuar vuajtje të mëdha apo dëmtime të integritetit trupor apo shëndetit, duke zbatuar masa të frikësimit kundër popullatës së rrezikuar civile, kryer vrasje, plaçkitur një qytet apo vend, urdhëruar zhvendosjen e popullatës civile për arsye që lidhen me konfliktin qëllimisht të drejtuar kundër popullatës civile apo kundër individëve të caktuar civilë të cilët nuk janë drejtpërdrejtë të përfshirë në konflikt. I akuzuari së bashku me persona të tjerë kanë hyrë me dhunë në shtëpitë e popullatës Shqiptare, duke e kërkuar personin me emër L, i cili atë ditë nuk ka qenë në shtëpinë e tij, e më pas kanë shkuar te shtëpia e të dëmtuarit AN, duke*

shtënë me armë-kallashnikov në ajër dhe më pas duke i urdhëruar me dhunë që të lëshojnë shtëpinë e tyre brenda 5 minutave, duke iu drejtuar në gjuhën Shqipe "Shqiptarët duhet të gjithë të vriten, shkoni në Shqipëri" , kësisoj duke i detyruar të dëmtuarin A dhe popullatën tjetër Shqiptare që të largohen nga shtëpitë e tyre, duke i ndarë ata në drejtime të kundërta, disa anëtarë të familjeve në drejtim të Shqipërisë, e të tjerët në drejtim të Malit të Zi."

18. Prokuroria Speciale kishte akuzuar parashtruesin e kërkesës se ka kryer vepra penale: *"Krime Lufte në shkelje të rëndë të nenin 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës, të cilat ndiqen penalisht sipas nenit 152, paragrafi 1, të Kodit Penal të Kosovës, dhe nenit 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, Krime Lufte në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konflikte të armatosura të cilët nuk janë të karakterit ndërkombëtar e të cilët ndiqen penalisht sipas nenit 153, paragrafi 1 dhe nën-paragrafit 2.1, 2.2, 2.5, 2.8, 2.13 12.15 dhe nenit 3 të KPK-së, në bashkimin fiktiv real."*

19. Më 11 shkurt 2021, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [ST.nr.15/19] vendosi: **(i)** Të akuzuarit Zoran Đokić (parashtruesit të kërkesës) i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) vjetësh, në këtë dënim përfshihet edhe koha e kaluar në paraburgim; **(ii)** Në pajtim me nenin 367 paragrafi 2 të KPPK-së, parashtruesit të kërkesës i vazhdohet paraburgimi deri sa ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm, por jo më gjatë se koha e paraparë në dispozitivin e këtij dënimi; **(iii)** Urdhërohet parashtruesi i kërkesës që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej 700 (shtatëqind) euro brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij aktgjykimi; **(iv)** të dëmtuarit V.B., L.Z., M.Z., Sh.K., M.Xh., F.M., L.H., F.H., dhe A.N., janë udhëzuar që në procedurë të rregullt civile të realizojnë të drejtat e tyre.

20. Gjykata Themelore e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Krime të Luftës Kundër Popullatës Civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, lidhur me nenin 3 të Konventës së Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe nenin 4 të Protokollit 2 të 8 qershorit 1977, shtojcë e Konventës së Gjenevës, duke e gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) vitesh me të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e qëndrimit në paraburgim.

21. Gjykata Themelore shpjegoi se kundër parashtruesit të kërkesës rëndonte akuza se më 28 mars 1999, në lagjen " Te Soliterat" që tash quhet "Rrokaqielli" (Soliter) në Pejë, parashtruesi i kërkesës në bashkëkryerje me një grup të forcave të armatosura serbe (policë rezervë, ushtarë dhe forca paramilitare) të veshur me uniforma, me qëllim që të shkaktojnë vuajtje të madhe dhe dëmtimit të shëndetit dhe integritetit trupor, duke zbatuar masa të frikësimit dhe terrorit ndaj popullatës së pambrojtur dhe të paarmatosur civile, kanë urdhëruar dëbimin e popullatës civile shqiptare e cila nuk ka qenë drejtpërsëdrejti e përfshirë në konflikt, parashtruesi i kërkesës me persona të tjerë ka hyrë me dhunë në shtëpitë e qytetarëve shqiptar dhe e ka kërkuar personin e quajtur L, i cili atë ditë nuk ka qenë në shtëpinë e tij, më pas kanë hyrë në shtëpinë e të dëmtuarit A.N, duke gjuajtur me pushkë automatike në ajër dhe duke i urdhëruar në mënyrë të dhunshme që në afat prej 5 minutash ta lëshojnë shtëpinë, dhe duke iu drejtuar me fjalë poshtëruese, kështu që A.N., dhe qytetarët tjerë shqiptar i kanë detyruar të lëshojnë shtëpitë, duke i ndarë në drejtime të kundërta, disa anëtar të familjes në drejtim të Shqipërisë dhe të tjerët në drejtim të Malit të Zi.

22. Gjykata Themelore shpjegoi se kundër parashtruesit të kërkesës rëndonte akuza se më 29 mars 1999, në lagjen "Kristal" në Pejë, parashtruesi i kërkesës, në bashkëkryerje me një grup të forcave të armatosura serbe (policë rezervë, ushtarë dhe forca paramilitare) të veshur me uniforma, me qëllim që të shkaktojnë vuajtje të madhe dhe dëmtimit të shëndetit dhe integritetit trupor, ndaj popullatës së pambrojtur civile të përkatësisë

shqiptare, kanë kryer vrasje, plaçkitje dhe kanë urdhëruar dëbimin e popullatës civile shqiptare nga shtëpitë e tyre, për arsye që lidhen me konfliktin e armatosur, ndonëse popullata civile ka qenë e pambrojtur dhe e paarmatosur dhe nuk ka marrë pjesë në luftime, kështu që, deri sa familja e të dëmtuarit L.H., saktësisht vëllai i tij B me familje dhe dy fëmijë të L.H., janë nxjerrë me dhunë nga shtëpia e tyre, pasi që kanë hyrë në veturën e tipi "Yugo 45 A" me ngjyrë portokalli, kanë tentuar t'i ndalojnë dhe ju kanë drejtuar me fjalët "ndalu, ndalu", për t'i vrarë kanë gjuajtur në drejtim të tyre, me ç 'rast vetura është goditur me katër të shtëna (plumba) në të cilin kanë qenë edhe dy fëmijë të mitur të dëmtuarit L.H., dhe djali më i madh nëntëvjeçar duke mbajtur për dore vëllain e tij trevjeçar që ta mbroj dhe ai goditet në dorën e djathtë përderisa më djali më i vogël është goditu me plumb në shpinë, me ç 'rast i janë shkaktuar lëndime trupore.

23. Gjykata Themelore, mes tjerash, kishte konstatuar: **(i)** bazuar në ligjet në fuqi gjatë luftës në Kosovë dhe në konventat ndërkombëtare, vihet në përfundim se krimet e luftës kundër civilëve mund të kryhen gjatë kohës së luftës, konfliktit të armatosur apo okupimit; **(ii)** sipas këtyre akteve ligjore vendore dhe ndërkombëtare, viktimat apo objekti i mbrojtur me ligj dhe konventa ndërkombëtare, janë kryesisht civilët, por mund të konsiderohen edhe pjesëtarët e forcave të armatosura të cilët i kanë dorëzuar armët dhe janë dorëzuar, si dhe personat e lënduar apo të sëmurë; **(iii)** krimet e luftës kundër popullatës civile sipas neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, në shkelje të nenit 3 të Konventës së Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe në shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 2 të 8 qershorit të vitit 1977, mund të kryhen nga kushdo që shkel rregullat dhe zakonet e luftës, kështu që kryerësi nuk kërkohet domosdo që t'i përkasë një formacioni të caktuar ushtarak ose paramilitar apo ndonjë formacioni tjetër; **(iv)** nuk është kontestuese se viktimat tashmë të ndjerët H.Z., S.Z., B.B., dhe R.M., janë gjetur në një varrezë masive në Batajnicë të Republikës së Serbisë; **(v)** sa i përket ditës kritike, fillimisht më 28 mars 1999 në Lagjen "Te Soliteri", tash të quajtur "Rrokaqielli" në Pejë, e më pastaj më 29 mars 1999, në Lagjen "Kristal" në Pejë, në bazë të dëshmive të dëshmitarëve është vërtetuar se pas bombardimeve të caqeve të ushtrisë dhe policisë serbe, si dhe të forcave paramilitare nga aleanca ushtarake e NATO-së, të cilat filluan më 24 mars 1999, në qytetin e Pejës, më saktësisht në këto dy vendbanime, filloi fushata e spastrimit etnik, të cilën dëshmitarët e përshkruan, për shkak se të gjithë këta dëshmitarë u dëbuan me dhunë nga shtëpitë dhe banesat e tyre për shkak të përkatësisë së tyre etnike shqiptare, duke përfunduar kryesisht si refugjatë në Mal të Zi; **(vi)** M.Z., e cila ishte dëshmitare e drejtpërdrejtë e krimeve të luftës që ndodhen, mes tjerash, ka dëshmuar se në ditën kritike ajo e ka parë V.B., duke qarë me zë të lartë, gjë e cila bashkë me provat tjera është e rëndësishme për veprën penale, por edhe për identifikimin e parashtruesit të kërkesës si një nga autorët; **(vii)** gjithashtu është e të njëjtës rëndësi edhe deklarata e M.Z., se emrin e parashtruesit të kërkesës si një pjesëmarrës në krim, e kishte dëgjuar në mesin e popullatës së zhvendosur me dhunë; **(viii)** dëshmia e dëshmitares-të dëmtuarës L.Z., është në përputhje të plotë me dëshminë e dëshmitares M.Z., gjykata vërtetoi faktet vendimtare lidhur me ditën kritike, nga strehimi në bodrum, ndarja e meshkujve nga gratë dhe fëmijët, plaçkitja e pasurisë së tyre, shpërngulja e dhunshme nga shtëpitë, dëbimi i tyre në Mal të Zi, marrja e informacionit nga një person se burri i saj ishte vrarë, derisa ajo ishte e shpërngulur në Ulqin, i cili i përmendi asaj edhe emrin e parashtruesit të kërkesës; **(ix)** dëshmia dëshmitares V.B., është e rëndësisë së lartë për njohjen e parashtruesit të kërkesës si pjesëmarrës në krimet e luftës derisa komunikonte me të duke iu lutur atij që të mos e rrëmbenin vëllain e saj, duke parë mirë fytyrën e parashtruesit të kërkesës, i cili i ka mbetur në kujtesë bazuar në fytyrën, sytë dhe flokët e tij; **(x)** dëshmia e dëshmitares është plotësisht në përputhje me dinamikën e krimit në ditën kritike, të cilën e kanë përshkruar pothuajse të gjithë dëshmitarët, sepse të gjithë kanë qenë banorë të së njëjtës lagje; **(xi)** për gjykatën dëshmia e dëshmitarit F.H., është e rëndësishme për shkak të një elementi, sepse dëshmitari, teksa fshihej në kulmin e shtëpisë së tij, prej nga shihej oborri i shtëpisë, ka arritur të shoh parashtruesin e kërkesës në oborr, me ç 'rast edhe i ka

përshkruar karakteristikat e tij fizike; **(xii)** dëshmia e F.H., vërteton në mënyrë shtesë faktin se ky dëshmitar ka mundur të dëgjojë radio komunikimin e këtyre personave të armatosur dhe të uniformuar, pra ai ka qenë në një distancë nga ku ka mundur të dëgjojë personin duke thënë *"Zoki a ka diçka atje"*, e që për gjykatën është shumë e qartë se Zoki është shkurtesa apo pseudonimi i parashtruesit të kërkesës; **(xiii)** dëshmitari A.N., përshkroi në detaje ditën kritike, duke dëshmuar se pas orës 12:00, parashtruesi i kërkesës, së bashku me një person të quajtur S, mbiemrin e të cilit nuk e dinte, një taksist dhe një person të katërt të cilin nuk e njihte, të armatosur me kallashnikovë dhe të veshur me uniforma të kamuflazhi ushtarake, shtinë me armë automatike në ajër dhe u dhanë pesë minuta kohë atyre që të largoheshin të gjithë; **(xiv)** dëshmitari A.N., ka deklaruar se parashtruesin e kërkesës e ka njohur dhe se ata të dytë kanë shkuar në të njëjtën shkollë "Ramiz Sadiku", ka deklaruar se për një kohë të shkurtër të parashtruesin e kërkesës e kanë quajtur "Zoki; **(xv)** deklarata e dëshmitarit A.N., përpos që është e rëndësishme për ngjarjen në Lagjen "Te Soliteri", gjykata në bazë të së njëjtës ka konstatuar edhe disa çështje të tjera relevante, e të cilat janë; se parashtruesi i kërkesës në momentin e kryerjes së krimit ka qenë në qytetin e Pejës, e jo në Beograd, siç ka thënë ai në alibinë e tij.

24. Parashtruesi i kërkesës gjatë gjitha fazave të zhvillimit të procedurës penale kishte paraqitur alibinë, duke pretenduar se në kohën e kryerjes së këtyre krimeve ai ka qenë në Beograd, Republika e Serbisë, më qëllim që të studioj. Në lidhje me këtë rrethanë shumë të rëndësishme të procedurës penale, Gjykata Themelore kishte dëgjuar disa dëshmitarë, si ata të propozuar nga ana e Prokurorisë, gjithashtu edhe ata të propozuar nga mbrojtja e parashtruesit të kërkesës.

25. Përkitazi me alibinë e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore, mes tjerash, kishte konstatuar: **(i)** nga dëshmia e dëshmitarëve F.Sh., dhe S.T., gjykata konstatoi faktin se parashtruesi i kërkesës ka punuar si roje sigurie në objektet e Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë në atë kohë dhe sipas fjalëve të udhëheqësit të tij të drejtpërdrejtë F.Sh., ai ka punuar aty nga mesi i muajit janar 1999 deri në evakuimin e misionit më 20 mars 1999; **(ii)** se parashtruesi i kërkesës ka punuar për Misionin Verifikues të OSBE-së e dëshmon edhe kopja e Kartelës së Personelit të Misionit Verifikues të OSBE-së gjatë vitit 1998-1999, e cila është paraqitur si provë materiale në shqyrtimin gjyqësor; **(iii)** dëshmitarja B.M., e cila në atë kohë jetonte në të njëjtën ndërtesë me parashtruesin e kërkesës, gjithashtu konfirmoi se parashtruesi i kërkesës së bashku me familjen e tij kanë qenë në banesën e tyre dhe se ajo e kishte parë atë tre deri në katër ditë para se popullata shqiptare e këtyre objekteve të dëbohej me dhunë nga aty; **(iv)** nga ana tjetër, dëshmitarët e mbrojtjes së parashtruesit të kërkesës S.M., dhe I.Ç., dëshmuan në favor të alibisë, së i akuzuarit gjatë kohës kur janë kryer veprat penale që janë objekt i kësaj çështjeje penale, ka qenë në Beograd; **(v)** dëshmitarja S.M., më pas e përshkroi situatën kur ajo dhe motra e parashtruesit të kërkesës, J, shkuan në Patriarkanën e Pejës për ta thirrur në telefon parashtruesin e kërkesës në Beograd, sepse për shkak të bombardimeve, linjat telefonike nëpër shtëpia nuk funksiononin; **(vi)** dëshmitari i mbrojtjes së parashtruesit të kërkesës I. Ç., gjithashtu dëshmoi në favor të alibisë së parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se ai dhe parashtruesi i kërkesës kanë studiuar në Universitetin "Braca Karic", i cili u zhvendos në Beograd si rezultat i luftës në Kosovë, dhe i përshkroi takimet e tij me të në qytetin e Beogradit; **(vii)** gjykata vërtetoi përtej çdo mëdyshjeje faktin se parashtruesi i kërkesës ka hyrë në marrëdhënie pune me Misionin Verifikues të OSBE-së, siç dëshmohet nga prova materiale-kartela identifikuese të tij e punës, dhe se sipas deklaratave të mbikëqyrësve të tij ai nuk ka munguar nga puna deri në evakuimin e këtij misioni, e që ishte diku midis datave 20 dhe 22 mars 1999; **(viii)** këto prova janë prova bindëse për gjykatën që dëshmojnë të kundërtën e alibisë së parashtruesit të kërkesës, e cila është paraqitur që në momentin e arrestimit, por edhe gjatë procedurës penale; **(ix)** parashtruesi i kërkesës ka ndryshuar datat e kinse largimit të tij në Beograd, dhe këtë e ka bërë duke qenë i

detyruar nga dëshmitë e dëshmitarëve të prokurorisë, të cilat kanë qenë prova bindëse, të argumentuara dhe me logjikë të arsyeshme se si do të vepronte një njeri i punësuar i cili kishte detyrime në punë; **(x)** përpjekjet e parashtruesit të kërkesës për ta ndërlidhur udhëtimin e tij në Beograd me faktin se ai e bëri këtë për të shmangur përgjegjësinë për mobilizim si pjesëtar i policisë rezervë janë jo-kredibile për gjykatën për faktin se Ministria e Punëve të Brendshme Serbe kryente kontrolle edhe në Serbi edhe në Kosovë në vitin 1999, dhe në rrethanat e kohës së shkuarjes në Beograd, nuk ka paraqitur një rrethanë në bazë të së cilës mund të argumentohej se i njëjti do të mund të shmangte detyrimin për t'u mobilizuar; **(xi)** mbrojtja e parashtruesit të kërkesës lidhur me alibinë e tij, së pari nuk është e saktë në aspektin e hapësirës kohore, pra ka pasur ndryshime me kalimin e kohës, ajo është e palogjikshme, nuk mbështetet në prova materiale, ndërsa dëshmitë e dëshmitarëve S.M., dhe I.Ç., nuk janë të besueshme për gjykatën sepse ato nuk kanë asnjë mbështetje në asnjë provë tjetër, por janë në kundërshtim me dëshmitë e dëshmitarëve F.Sh., S.T., dhe B.M., dhe janë gjithashtu në kundërshtim edhe me dëshmitë e dëshmitarëve A.N., dhe të gjithë dëshmitarëve të cilët e kanë identifikuar të akuzuarin si pjesëmarrës në krim; **(xii)** gjykata pajtohet plotësisht me pohimin e parashtruesit të kërkesës, që barra e provës bie mbi prokurorinë dhe në këtë rast prokuroria me provat e propozuara dhe të administruara në shqyrtimin kryesor ka arritur të dëshmojë të kundërtën e alibisë së parashtruesit të kërkesës; **(xiii)** kuptohet se vetëm dëshmia e rreme e një alibie në lidhje me vendndodhjen (vendbanimin) në shumicën e rasteve nuk mjafton për të shpallur një person përgjegjës, ajo nuk mjafton as në këtë rast, por fajësia e parashtruesit të kërkesës është dëshmuar edhe me prova të tjera të drejtpërdrejta; **(xiv)** teoria e mbrojtjes së parashtruesit të kërkesës shkoi edhe në drejtim të mohimit apo përpjekjes për shpalljen e pavlefshme të disa provave materiale, siç është deklarata e dëshmitarit Sh.K., e dhënë më 5 qershor 2000, në KMLDNJ duke vënë në pyetje vendin e dhënies së dëshmisë, për të cilën gjë gjykata nuk ka dyshim se e njëjta datë është dhënë në Pejë në ditën e cekur, e jo në Ulqin siç është cekur, sepse qyteti i Ulqinit përmendet në rubrikën (seksionin) si qyteti në të cilin dëshmitari u zhvendos gjatë luftës; **(xv)** në lidhje me provat materiale, në kopjen e listës së datës 3 qershor 1999, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme-Sekretariati në Pejë, nga Komandanti i Stacionit Policor, Majori M.S., nën numrin një figuron emri i parashtruesit të kërkesës si pjesëtar i njësive rezervë të MPB-së të Serbisë dhe për të gjithë këta pjesëtarë janë shënuar vetëm emrat dhe mbiemrat pa të dhëna tjera; **(xvi)** gjithashtu në bazë të këtij dokumenti thuhet se parashtruesi i kërkesës ka qenë i angazhuar më 21.04. 1999; **(xvii)** teoria e mbrojtjes se në këtë rast kemi të bëjmë me një person tjetër të quajtur Zoran Đokić nuk qëndron dhe bie ndesh me provat materiale të lexuara në shqyrtimin gjyqësor; provat e siguruara nga burime të hapura të Ministrisë së Brendshme që në vitin 1999 publikuan në ueb faqen e saj; **(xviii)** prandaj, për gjykatën është e qartë se polici tjetër i quajtur Zoran Đokić është vrarë në kohën e kësaj aktakuze, ndërsa burimi nga i cili është marrë ky informacion i përket burimeve të hapura dhe është shumë i besueshëm sepse bëhet fjalë për ueb-faqen e qeverisë së Serbisë, dhe këto teknika hetimore në përputhje dhe me legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe më gjerë janë të njohura dhe të pranueshme; **(xix)** gjykata ka konstatuar se ka qenë shumë më herët i ngarkuar më një automatik Kallashnikov dhe se çështja e datës e cila paraqitet në dokument është për qëllime administrative dhe nuk ka dyshim se parashtruesi i kërkesës ka qenë i angazhuar në terren, nga fillimi i bombardimeve të NATO-së ndaj caqeve serbe, pasi që ai edhe vetë e ka pranuar se mbrojtja territoriale e ka ngarkuar me pushkë automatike; **(xx)** krimet e luftës janë krime specifike, të cilat në disa raste zbulohen pas shumë e shumë vitesh, prandaj ato edhe nuk vjetërsohen, pra këto krime nuk bëjnë pjesë në grupin e krimeve të zakonshme, për të cilat ekzistojnë prova mjeko-ligjore dhe balistike; **(xxi)** andaj, parashtruesi i kërkesës gjatë kësaj periudhe ishte i kujdesshëm në lëvizjen e tij dhe thjesht supozonte se në grupin e forcave ushtarake që kryen krimet ai ka mbetur i pavërejtur; **(xxii)** cilësimi juridik i veprës penale gjithashtu lidhet edhe me funksionimin e ligjit në atë kohë, prandaj gjykata

kundrejt parashtruesit të kërkesës e zbatoi ligjin i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

26. Përkitazi me identifikimin e të akuzuarit-parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore, mes tjerash konstatoi: **(i)** dëshmitari A.N., në seancën e datës 09.07.2020, gjatë dëshmisë së tij, pasi që ka dhënë shumë informacione për parashtruesin e kërkesës, duke dëshmuar se ata kanë vijuar mësimet në shkollën e njëjtë dhe se ai e njihte atë prej kohësh, duke dhënë detaje rreth kafetërive ku parashtruesi i kërkesës punonte si kamerier, në sallën e gjyqit e ka identifikuar parashtruesin e kërkesës si pjesëmarrës në krimet e 28 marsit 1999 në Lagjen "Te Soliteri"; **(ii)** gjithashtu edhe dëshmitari F.H., gjatë dëshmisë së tij në shqyrtimin gjyqësor më 18.06.2020 ka deklaruar se pasi që ka dëgjuar për arrestimin e parashtruesit të kërkesës, ai e ka kërkuar emrin e tij në Facebook dhe në mesin e disa personave me të njëjtin emër e ka identifikuar parashtruesin e kërkesës si personin i cili ka shtënë në të dhe në dajën e tij me pushkë automatike; **(iii)** dëshmitarët si V.B., dhe M.Xh., e kanë identifikuar parashtruesin e kërkesës përmes fotografive në mënyrën e paraparë me ligj; **(iv)** dëshmitarët V.B., dhe M.Xh., nuk kanë pasur mëdyshje gjatë identifikimit, ata i kanë përshkruar me saktësi karakteristikat fizike të parashtruesit të kërkesës, duke dhënë shpjegime edhe për rrethanat në të cilat janë takuar dhe komunikimin që kanë pasur me të akuzuarin ditën e krimit; **(v)** gjithashtu, edhe dëshmitarët A.N., dhe F.H., e kanë identifikuar qartë parashtruesin e kërkesës dhe i kanë treguar se në bazë të cilave karakteristika e kanë dalluar atë, si flokët dhe sytë, të cilat karakteristika fizike të këtij të akuzuari janë të dallueshme dhe bien në sy, gjë që e bën të parëndësishme ngjyrosjen e fytyrës në pjesë të caktuara; **(vi)** gjithashtu edhe dëshmitari M.Xh., i cili në ditën kritike ka pasur kontakt parashtruesin e kërkesës, e ka identifikuar dhe përshkruar atë si personi i cili ka marrë pjesë në aksionin e dëbimit dhe terrorizimit të popullatës civile shqiptare; **(vii)** se parashtruesi i kërkesës ka qenë pjesëtar i policisë rezervë, e dëshmon prova materiale, kopja e listës së datës 03.06.1999 të cilën e ka lëshuar Ministria e Punëve të Brendshme - Sekretariati në Pejë, përmes Komandantit të Stacionit Policor kryesor-M.S.; **(viii)** përderisa fakti se nuk bëhet fjalë për një person tjetër me të njëjtin emër dhe mbiemër vërtetohet nga prova materiale e siguruar nga burime të hapura, se Ministria e Punëve të Brendshme në vitin 1999 e publikoi listën e policëve të vrarë të Kosovës në vitin 1998; **(ix)** se parashtruesi i kërkesës ka qenë pjesëtarë i këtyre forcave të cilat në shenjë hakmarrjeje ndaj bombardimeve të caqeve ushtarake serbe nga ana e NATO-së, kanë kryer këto krime në qytetin e Pejës, e deklaron edhe dëshmitari A.N., i cili ishte viktimë e dhunës më 28 mars 1999, në Lagjen "Te Soliteri", dhe i cili saktë e ka identifikuar parashtruesin e kërkesës si pjesëtar të këtyre forcave; **(x)** po ashtu edhe në Lagjen "Kristal", një ditë më vonë, ku dëshmitari F.H., e ka dëgjuar me saktësi komunikimin në radio lidhje, midis ushtarëve që përmendnin emrin "Zoki", nga ku ai e kuptoi se parashtruesi i kërkesës ishte personi që shtiu në të dhe në dajën e tij, i cili ishte në kërkim të tyre dhe hyri në oborrin e shtëpisë së tij, se shkurtimisht parashtruesin e kërkesës e quanin "Zoki"; dhe se; **(xi)** dëshmitari F.H., ka qenë në gjendje ta shoh parashtruesin e kërkesës përmes zgavrave të dërrasave të çatisë së shtëpisë së tij.

27. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës që mbrojtësi i tij të jetë i pranishëm gjatë identifikimit të këtij të parit përmes fotografisë, Gjykata Themelore sqaroi: *"Në lidhje me identifikimin e personit përmes fotografisë, gjykata konstatoi se ky identifikim është bërë në përputhje me dispozitën e nenit 120 të KPPK-së, që është dispozitë e veçantë që rregullon identifikimin e një personi apo gjësendi (sendi) dhe në asnjë nga paragrafët e nenit të përmendur nuk kërkohet dhe nuk është e domosdoshme prania e mbrojtësit. Mbrojtja e të pandehurit gabimisht i referohet dispozitës së nenit 61, paragrafi 3, e cila parasheh: mbrojtësi ka të drejtë të njoftohet me kohë për vendin dhe kohën e zbatimit të veprimeve hetimore, të marrë pjesë në to dhe të shikojë shkresat e lëndës dhe provat e çështjes në pajtim me dispozitat e këtij Kodi. Pra, kjo është një dispozitë e përgjithshme, e cila në pjesën e fundit konstaton se kjo e drejtë*

është në pajtim me dispozitat e kodit, që do të thotë se vetëm në rastet kur kjo është në mënyrë eksplicite e definuar me dispozitë konkrete, mbrojtësi e ka këtë të drejtë, p.sh. siç është përcaktuar në dispozitën e nenit 132, paragrafi 5, të KPPRK-së, me rastin e marrjes së deklaratës në procedurën paraprake, ndërsa neni 120 i KPPRK-së, nuk e parasheh një obligim të tillë."

28. Përkitazi me proporcionalitetin e aktgjykimit dënues, Gjykata Themelore arsyetoi: "*Me rastin e vendosjes mbi lartësinë e dënimit, gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat e parapara në nenin 41 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ), të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ku në këtë rast si rrethanë lehtësuese gjykata e ka marrë faktin se nuk ka të dhëna se i akuzuari Zoran Đokić ka kryer vepra penale në të kaluarën, ndërsa si rrethanë rënduese në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata e ka marrë parasysh shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të akuzuarit Zoran Đokić në kryerjen e veprës penale dhe shkallën e lartë të shkeljes së të drejtës së mbrojtur. Bazuar në këto rrethana, gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe rrezikshmërinë specifike të veprës penale, e bindur se me dënimin si në dispozitivin të këtij aktgjykimi dënues, do të arrihet qëllimi i dënimit në aspektin e parandalimit të veçantë, dhe se ky dënim do të ndikojë në të pandehurin, që të përmbahet nga përsëritja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të arrihet qëllimi i dënimit në aspektin e parandalimit të përgjithshëm, që dënimi të parandalojë edhe personat e tjerë në kryerjen e veprave penale, t'i ofrojë kompensim të dëmtuarve për dëmin e shkaktuar nga vepra penale, por edhe shpreh edhe dënimin e ashpër nga shoqëria të krimit, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për t'iu bindur ligjit.*"

29. Më 4 qershor 2021, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit dënues të Gjykatës Themelore duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe vendimit për dënimin dhe shpenzimet e procedurës. Parashtruesi i kërkesës propozoi ankesa të aprovohet e bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet në atë mënyrë që parashtruesin e kërkesës ta liroj nga aktakuza sepse nuk është provuar se ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet ose që këtë aktgjykim ta prish dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

30. Ndërsa Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, kërkoi që për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të shqiptohet dënim më i lartë apo lënda t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

31. Më 12 tetor 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [APS.nr.22/2021] vendosi: **(i) REFUZOHEN** të pabazuara ankesat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës si dhe e parashtruesit të kërkesës; ndërsa, **(ii) VËRTETOHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore [ST.nr.15/19] i datës 04.02.2021.

32. Gjykata e Apelit përfundoi se konkludimet e gjykatës së shkallës së parë janë të qarta dhe në pajtueshmëri me provat e administruara, vlerësoi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale të theksuara nga palët për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset zyrtarisht, nuk konstatohet vërtetim i gabuar dhe i jo i plotë i gjendje faktike, si dhe nuk konstatohet aplikim i gabuar i ligji penal. Rrjedhimisht, ankesat e Prokurorisë Speciale dhe e parashtruesit të kërkesës janë të pabazuara.

33. Gjykata e Apelit, mes tjerash, konstatoi: **(i)** aktgjykimi nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave nga neni 384 të KPPRK-së për të cilat palët pretendojnë, dhe

për të cilat gjykata kujdeset zyrtarisht, gjegjësisht aktgjykimi përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për vërtetimin e fakteve vendimtare nga të cilat varet zbatimi i drejtë i dispozitave të ligjit penal; **(ii)** pretendimi ankimor se ekziston shkelje e dispozitës së nenit 288 par.2 të KPPRK-së, është i pabazuar pasi paragrafi 1, i dispozitës së cituar, lejon palët, mbrojtësin dhe të dëmtuarin edhe pas caktimit të shqyrtimit kryesor mund të kërkojnë që në shqyrtim kryesor të thirren dëshmitarë dhe ekspertë të rinj ose të mblidhen prova të reja; **(iii)** për më tepër është fakt që dispozita e nenit 288 par. 2 të KPPRK-së kujdeset në mënyrë të veçantë, për të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë, në mënyrë që të mos cenohet në rast të refuzimit të provës së propozuar, por nuk nënkupton se propozimet nga palët dhe të dëmtuarit për dëgjimin e dëshmitarëve dhe provave të reja duhet të jenë vetëm në favor të akuzuarit-parashtruesit të kërkesës; **(iv)** Kolegji konsideron mos informimi i mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës për të marrë pjesë në veprimet hetimore apriori nuk i bënë prova të papranueshme, pasi që mbrojtja kishte mundësin për të kundërshtuar ligjshmërinë dhe t'i vë në diskutim provat e siguruara gjatë veprimeve të caktuara hetimore gjatë fazave të mëtutjeshme të procedurës penale, shkelja e tillë duhet të vlerësohet në kontekstin e ndikimit në rregullsinë dhe ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe një lidhje shkakësore e tillë duhet provuar dhe jo supozuar, andaj shkelja e tillë në dritën e rrethanave të çështjes konkrete nuk konsiderohet si shkelje thelbësore e dispozitave të procedurës penale; **(v)** Kolegji vlerëson se kjo situatë bën fjalë për ndryshim dhe zgjerim të aktakuzës e cila bëhet në kuptim të nenit 351 të KPPRK-së, si rezultat i provave dhe fakteve që rezultojnë në shqyrtimin kryesor, theksimi se janë shkelur dispozitat imperative nga neni 241 par.1.1.7 të KPPRK-së të cilat kërkojnë që aktakuza të përmbajnë arsyetimin është i paqëndrueshëm; **(vi)** në këtë rast, sipas pikëpamjes së prokurorit kanë derivuar fakte të reja që kanë kushtëzuar ndryshimin dhe zgjerimin e akuzës, njëkohësisht prokurori i ka dhënë të parashtruesit të kërkesës, në kohë, dhe me qartësi informacion që detajizon bazën faktike mbi të cilën janë ndryshuar dhe zgjeruar akuzat kundër tij; **(vii)** ekziston dallueshmëria me rastin e ndryshimit dhe zgjerimit të akuzës në këtë momentum procedural, në dallim prej ngritjes së aktakuzës fillestare, në këtë aspekt aktakuza mund të ndryshohet dhe zgjerohet edhe gojarisht në procesverbal apo të propozohet ndërprerja për përgatitjen e aktakuzës se re; **(viii)** megjithatë në çdo situatë është detyrë e gjykatës është që t'i ofrojë mundësi dhe kohë mbrojtjes që të përgatitet, nga procesverbali i shqyrtimit kryesor konstatohet se një mundësi e tillë i është dhënë mbrojtjes së parashtruesit të kërkesës; **(ix)** për të përcaktuar nëse kishte tejkalim të akuzës, veprimet e parashtruesit të kërkesës për të cilën ngarkohet ai sipas aktgjykimit duhet vështruar në kuadër të tërësishëm të veprimeve inkriminuese të ngjarjes të përshkruara në aktakuzën e ndryshuar, dhe jo duke e shkëputur vetëm këtë fragment si të izoluar nga ngjarja dhe rrjedha e saj në relacion me viktimën B.B. **(x)** fakti se gjykata në aktgjykim ka konstatuar një fakt të tillë në bazë të dëshmisë së të dëmtuarës V.B., nuk konsiderohet tejkalim i aktakuzës për arsye se: **a)** nuk ndryshohet kualifikimi juridik i veprës penale (cilësimi për një vepër më të rëndë penale, apo vepër penale me natyrë tjetër dhe jashtë kapitullit për të cilën akuzohet); **b)** nuk ndryshohet roli i tij në kryerjen e veprës penale, sipas aktakuzës dhe aktgjykimit pasi që akuzuari akuzohet si bashkëkryes me persona tjerë dhe ka mbetur i tillë edhe sipas aktgjykimit; **c)** ndryshimi konsiston në kuadër të ngjarjes së njëjtë penale që ka ndodhur dhe në pajtueshmëri me rezultatin provues të cilën trupi gjykues veprimet e caktuara inkriminuese i ka konstatuar si të provuara.

34. Përkitazi me vërtetësinë dhe besueshmërinë e dëshmitarëve, Gjykata e Apelit, mes tjerash, vlerësoi: "*Dëshmitarë të ndryshëm të sipërmendur, në situata të caktuara të ngjarjeve ishin prezent, u ballafaquan dhe vërejtën të akuzuarin. Për më tepër deklarimet e dëshmitarëve janë specifike në raport me veçorit dhe karakteristikat tipike të akuzuarit si ngjyra e syve, fytyra, flokët, gjatësia trupore. Këto rrethana të marra ndaras tregojnë për të provuarit e faktit të pjesëmarrjes së të akuzuarit në ngjarjet kriminale, këto dëshmi të ndërlidhura në unitetin e tyre plotësohen mes vete,*

japin një pasqyre te plote dhe provojnë ne mënyrë të padyshimtë pjesëmarrjen, rolin dhe kontributin e të akuzuarit në kryerjen veprave penale për të cilën akuzohet. Për rrjedhojë identifikimi nga një numër i dëshmitarëve me përshkrimet specifike të tipareve të akuzuarit, në rrethanat e ndryshme të ngjarjeve inkriminuese tregon për një identifikim real dhe të sigurt. Prandaj, mund të konkludohet se kuantumi i tërësishëm i fakteve dhe informatave të drejtpërdrejta të ofruara paraqet material të mjaftueshëm provues dhe identifikues, si i tillë mund të shërbej për një përfundim të qartë dhe të saktë për përgjegjësinë penale të akuzuarit si rezultat i pjesëmarrjes në formën e bashkëkryerjes me persona tjerë në kryerjen e veprave penale siç përshkruhen ne aktgjykim për të cilat është shpallur fajtor."

35. Më 10 janar 2022, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë kërkesën të bazuar dhe të nxjerrë aktgjykim me të cilin do të ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara, ashtu që parashtruesin e kërkesës ta lirojë nga akuza ose aktgjykimet t'i anulojë dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

36. Më 20 janar 2022, Prokurori i Shtetit me shkresën [KMLP.II.nr.13/2022] i propozoi Gjykatës Supreme që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit e parashtruesit të kërkesës të refuzohet e pabazuar.

37. Më 5 shkurt 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml.nr.19/2022] vendosi: **REFUZOHET** e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e parashtruesit të kërkesës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [PS.nr.15/2019] të datës 11.02.2021 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [APS.nr.22/2021] të datës 12.10.2021.

38. Gjykata Supreme arsyetoi: **(i)** siç rezulton nga shkresat e çështjes, aktgjykimet e kundërshtuara si tërësi, pra edhe dispozitivat e të njëjtëve janë të qartë, të kuptueshëm dhe nuk përmbajnë kundërthënie me vetvete ose me arsyet e paraqitura; **(ii)** lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se gjykata e shkallës së parë e ka tejkaluar akuzën, Gjykata Supreme shpjegoi se nuk ndryshohet roli i tij në kryerjen e veprës penale, sipas aktakuzës dhe aktgjykimit pasi që i akuzuari akuzohet si bashkë-kryes me persona të tjerë dhe ka mbetur i tillë edhe sipas aktgjykimit; **(iii)** ndryshimi i aktakuzës konsiston në kuadër të ngjarjes së njëjtë penale që ka ndodhur, dhe në pajtueshmëri me rezultatin provues; **(iv)** gjykata e shkallës së parë në aktgjykim ka konstatuar një version të ngjarjes që është ma favorizues për parashtruesin e kërkesës, përkatësisht se ndaj viktimës ka shtënë një pjesëtar i grupit të armatosur, prandaj në tërësinë e saj parashtruesit të kërkesës nuk i është vështirësuar gjendja në raport me vëllimin inkriminues që është akuzuar sipas aktakuzës së ndryshuar dhe zgjeruar; **(v)** nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimet e kundërshtuara rezulton se gjykatat i kanë dhënë mundësi dhe kohë parashtruesit të kërkesës që të përgatitet, e kjo konstatohet nga procesverbali i shqyrtimit kryesor se një mundësi e tillë i është dhënë parashtruesit të kërkesës; **(vi)** neni 288 par.1 i KPPK-së, lejon palët, mbrojtësin dhe të dëmtuarin edhe pas caktimit të shqyrtimit kryesor mund të kërkojnë që në shqyrtimin kryesor të thirren dëshmitarë dhe ekspertë të rinj ose të mblidhen prova të reja, e jo siç pa të drejtë pretendon parashtruesi i kërkesës se në rastin konkret kjo do të vlente vetëm për parashtruesin e kërkesës dhe assesi për palën e dëmtuar; **(vii)** pretendimi i parashtruesit të kërkesës për mos informimin e mbrojtësit për të marrë pjesë në veprime hetimore apriori nuk e bënë provën të jetë e papranueshme, pasi që mbrojtja e kishte mundësinë për ta kundërshtuar ligjshmërinë dhe t'i vë në diskutim provat e siguruara gjatë veprimeve të caktuara hetimore gjatë fazave të mëtutjeshme të procedurës penale; **(viii)** shkelja e tillë duhet të vlerësohet në kontekstin e ndikimit në

rregullsinë dhe ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe në rastin konkret kjo nuk paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale; **(ix)** pretendimi i parashtruesit të kërkesës se është shkelur ligji penal në dëm të tij, është i pabazuar, për faktin se gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë zbatuar ligjin penal mbi gjendjen e tillë të fakteve të vërtetuara, dhe **(x)** rrjedhimisht, nuk ekziston shkelja e ligjit penal, sepse në veprimet e të dënuarit qëndrojnë të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

39. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (3) a) dhe d) të KEDNJ-së dhe nenin 9 (2) të KNDCP-së.

40. Përkitazi me dëgjimin e dëshmitarëve, parashtruesi i kërkesës pretendon: "*Gjatë hetimit të zhvilluar nga ana e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës kundër Zoran Đokićit, janë marrë në pyetje 17 dëshmitarë. Në aktakuzë, kjo prokurori ka propozuar që të dëgjohen vetëm 9 (nëntë) dëshmitarë. Pa kurrfarë arsyetimi është anashkaluar marrja në pyetje e 8 (tetë) dëshmitarëve. Megjithatë, arsyeja pse u bë kjo ishte më se e qartë: tetë dëshmitarët të cilët prokuroria nuk ka dashur t'i dëgjojë në shqyrtimin kryesor kanë dëshmuar në favor të Zoran Đokićit gjatë hetimeve, ose dëshmitë e tyre kanë qenë neutrale. Është propozuar vetëm dëgjimi i dëshmitarëve të cilët e kanë ngarkuar Zoran Đokićin. Gjykatat e shpërfillën këtë fakt.*"

41. Përkitazi me pranimin e dëshmitarëve pas caktimit të shqyrtimit kryesor, parashtruesi i kërkesës pretendon: **(i)** në aktakuzën kundër parashtruesit të kërkesës, prokuroria ka propozuar dëgjimin e një numri të caktuar dëshmitarësh në shqyrtimin kryesor; **(ii)** mbrojtja e parashtruesit të kërkesës, brenda afatit ligjor, ndërmjet shqyrtimit të parë dhe dytë fillestar, e dorëzoi listën e saj të dëshmitarëve si në gjykatë ashtu edhe në prokurori; **(iii)** shumë më vonë, jo më herët se në shqyrtimin kryesor, përfaqësuesi i autorizuar palës së dëmtuarës propozoi që të dëgjohen dëshmitarë të rinj; (iv) mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës e kundërshtoi këtë, duke u thirrur në nenin 288, paragrafi 2 i KPPRK-së, sepse propozimi i dëshmitarëve të rinj mund të pranohet vetëm nëse dëshmitarët e propozuar nuk janë njohur në kohën e mbajtjes së shqyrtimit të dytë fillestar; **(v)** këta dëshmitarë ishin të njohur asokohe, sepse gjatë ngjarjes kontestuese, si dhe më vonë kanë jetuar në lagjen "Kristal" në Pejë, që është fakt i padiskutueshëm; **(vi)** edhe përkundër kësaj, gjykata e shkallës së parë pranoi dëgjimin e këtyre dëshmitarëve dhe ekskluzivisht në bazë të dëshmisë së tyre, e shpalli fajtor dhe e dënoi parashtruesin e kërkesës.

42. Përkitazi me ndryshimin dhe zgjerimin e aktakuzës, parashtruesi i kërkesës pretendon: **(i)** atij asnjëherë, në asnjë mënyrë, nuk i është dhënë mundësia që të mësojë arsyet mbi të cilat prokuroria e zgjeroi, e ndryshoi dhe e ashpërsoi aktakuzën kundër tij; **(ii)** këtë mundësi nuk e kanë dhënë as gjykatat e rregullta, por megjithatë një aktakuzë të tillë ato e kanë pranuar dhe e kanë shpallur fajtor dhe dënuar me shumë vite burgim parashtruesin e kërkesës; **(iii)** gjithashtu, parashtruesit të kërkesës nuk iu dha mundësia të deklarohet për aktakuzën e ndryshuar dhe të zgjeruar kundër tij.

43. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përveç shkeljes të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 (3) a) dhe d) të KEDNJ-së, në dëm të tij, po ashtu janë shkelur edhe dispozitat e KPPRK-së, të cilat kanë qenë të rëndësisë thelbësore që gjykimi të mos jetë i drejtë dhe i paanshëm.

44. Përkitazi me të drejtën që të jetë i pranishëm gjatë veprimeve hetimore, parashtruesi i kërkesës pretendon: "*Duke u thirrur në nenin 61, paragrafi 3, menjëherë pas arrestimit të të akuzuarit Đokić, avokati mbrojtës i të akuzuarit Đokić kërkoi nga prokuroria që ta lejojë atë të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet hetimore, dhe që paraprakisht të njoftohet për kohën dhe vendin e zhvillimit të tyre. Prokuroria e informoi mbrojtësin vetëm për dy veprimet hetimore-marrjen në pyetje të të akuzuarit Đokić (që nuk mund të bëhej edhe pa praninë e mbrojtësit) si dhe për bastisjen e banesës ku i pandehuri ka jetuar deri në muajin mars të vitit 1999. Të gjitha veprimet e tjera hetimore – marrja në pyetje e dëshmitarëve, palëve të dëmtuara, identifikimi i të akuzuarit, e veprime tjera, janë kryer pa praninë e mbrojtësit të cilën ai e ka kërkuar shprehimisht, me shkrim.*"

45. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) të konstatojë se gjykatat e instancave më të ulëta kanë bërë lëshime me të cilat janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës, e të cilat të drejta dhe liri janë të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës; (ii) të konstatojë se me aktgjykimet e kontestuara është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe; (iii) për shkak të shkeljeve të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të tri aktgjykimet e cekura në këtë kërkesë, të anulohen.

Dispozitat relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.

7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit."

Neni 53
[Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

"Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht,publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq."

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj

Neni 9
(Pa titull)

"1. Secili ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë së personit të tij. Askush nuk duhet të jetë objekt i një arrestimi ose burgimi arbitrar. Askush nuk duhet të privohet nga liria, përveç për arsye dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj.

2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet, në çastin e arrestimit, për arsyet e arrestimit dhe menjëherë duhet të njoftohet lidhur me çdo akuzë që bëhet kundër tij.

3. Çdo person i arrestuar ose i ndaluar për shkak të një vepre penale duhet të nxirret, pa vonesë, përpara një gjykatësi ose ndonjë zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për ushtrimin e funksioneve gjyqësore dhe duhet të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet. Ndalimi i personave të cilët presin të gjykohen nuk duhet të jetë rregull i përgjithshëm, por lirimi mund të kushtëzohet me garanci për të siguruar daljen e të interesuarit para gjyqit, në cilëndo fazë tjetër të procedurës gjyqësore, dhe po qe se paraqitet nevoja, edhe për ekzekutimin e gjykimit.

4. Çdo person që privohet nga liria e tij me masa arrestimi ose ndalimi ka të drejtë ankese në një gjykatë me qëllim që kjo të vendosë, pa vonesë, lidhur me ligjshmërinë e masës së ndalimit dhe të urdhërojë lirimin e tij në qoftë se ndalimi është i paligjshëm.

5. Çdo person që është viktimë e një arrestimi ose ndalimi të paligjshëm ka të drejtë dëmshpërblimi."

Konventat e Gjenevës nga 12 gushti 1949 dhe Protokollet Shtesë nga 1977 dhe 2005

Neni 3
(Konfliktet pa karakter ndërkombëtar)

"Në rast të një konflikti të armatosur i cili nuk ka karakter ndërkombëtar në territorin e njërës nga Palët e Larta Kontraktuese, secila palë në konflikt është e detyruar të zbatojë, si minimum, dispozitat e mëposhtme:

(1) Personat që nuk janë të përfshirë direkt në armiqësi, përfshirë edhe pjesëtarët e forcave të armatosura që kanë dorëzuar armët dhe personat e paaftë për të luftuar për shkak të një sëmundje, plagë, privim të lirisë, ose për ndonjë arsye tjetër, do të trajtohen në çdo mundësi në mënyrë njerëzore, pa ndonjë dallim të pafavorshëm bazuar në racën, ngjyrën, fenë ose bindjen, gjininë, lindjen ose pronën, ose ndonjë standard tjetër të ngjashëm. Për këtë qëllim, për personat e lartpërmendur, janë të ndaluara dhe ndalohen në çdo kohë dhe në çdo vend veprimet e mëposhtme:

(a) plagosje për jetën dhe integritetin trupor, në veçanti të gjitha format e vrasjeve, gjymtimit, mizorisë dhe torturës;

b) marrja e pengjeve;

c) shkelja e dinjitetit personal, në veçanti trajtimi fyes dhe poshtërues;

(d) shqiptimi dhe ekzekutimi i dënimeve pa gjykim të mëparshëm nga një gjykatë e rregullt, shoqëruar nga çdo garanci gjyqësore e njohur nga popujt e civilizuar si të domosdoshme.

(2) Të plagosurit dhe të sëmurët do të pranohen dhe do të kujdesen.

Një organizatë humanitare e paanshme, siç është Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, mund t'ua ofrojë shërbimet e saj Palëve në konflikt.

Palët në konflikt do të përpiqen, me anë të marrëveshjeve të posaçme, të sjellin në fuqi të gjitha ose një pjesë të dispozitave të kësaj Konvente.

Zbatimi i dispozitave të mëparshme nuk ndikon në pozicionin juridik të Palëve në konflikt."

Protokolli II

Protokolli Shtesë i Konventave të Gjenevës së 12 Gushtit të Vitit 1949 për Mbrojtjen e Viktimave të Konflikteve të Armatosura Jo Ndërkombëtare i 8 Qershorit të Vitit 1977

Pjesa II - Trajtimi Njerëzor

Neni 4
(Garancitë themelore)

"1. Të gjithë personat që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt ose që kanë pushuar së luftuari, pavarësisht nëse është kufizuar liria e tyre ose jo, kanë të drejtë të respektohet personaliteti, nderi dhe bindja dhe ritet fetare të tyre. Ata në të gjitha rrethanat do të trajtohen në mënyrë njerëzore, pa asnjë diskriminim. Është e ndaluar të jepet urdhër që të mos ketë të mbijetuar.

2. Pa cenuar karakterin parimor të sipërpërmendurës, veprat e mëposhtme kundër personave të përmendur në paragrafin 1 janë dhe mbeten të ndaluara në çdo kohë dhe në çdo vend:

(a) dhuna ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqenies fizike ose mendore të njerëzve, në veçanti vrasja dhe trajtimi mizor, siç janë torturat, frikësimi ose ndonjë formë e ndëshkimit trupor;

(b) dënimet kolektive;

(c) marrja e pengjeve;

(d) aktet e terrorizmit;

(e) fyerja e dinjitetit njerëzor, veçanërisht trajtimi poshtërues dhe degradues, përdhunimi, prostitucioni i detyruar dhe çdo formë e një sulmi të pahijshëm;

(f) skllavëria dhe tregtia e skllevërve në të gjitha format e saj;

(g) plaçkitja;

(h) kërcënimi për të kryer cilindo nga veprimet e mësipërme.

3. Fëmijëve do t'u sigurohet kujdesi dhe ndihma e nevojshme, dhe veçanërisht:

(a) do të pajisen me arsimim, përfshirë arsimin fetar dhe moral, në përputhje me dëshirat e prindërve të tyre ose, në mungesë të prindërve, të atyre personave që janë përgjegjës për t'u kujdesur për ta;

(b) do të merren të gjitha hapat e duhur për të lehtësuar ribashkimin e familjeve të ndara përkohësisht;

(c) fëmijët që nuk kanë mbushur moshën 15 vjeç nuk do të rekrutohen në forca ose grupe të armatosura, dhe as nuk do të lejohen të përfshihen në armiqësi;

(d) mbrojtja e veçantë e parashikuar në këtë nen për fëmijët që nuk kanë mbushur moshën 15 vjeç do të zbatohet për ta edhe nëse ata marrin pjesë drejtpërdrejt në armiqësi, pavarësisht nga dispozitat e nën-paragrafit (c), dhe kapen;

(e) do të merren masa, nëse është e nevojshme dhe kur është e mundur, me pëlqimin e prindërve të tyre ose personave që, me ligj ose me zakon, janë kryesisht përgjegjës për

kujdesin e tyre, për të strehuar përkohësisht fëmijët nga zona ku kanë filluar armiqësitë në një zonë më të sigurt, brenda vendit, dhe do të sigurohet që ata të shoqërohen nga persona përgjegjës për sigurinë dhe mirëqenien e tyre."

KODI NR. 04/L-082
KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS (publikuar në Gazetën Zyrtare më 13 korrik 2012 ndërsa është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Kodit Penal Nr.06/074)

Neni 3
Zbatimi i ligjit më të favorshëm

"1. Ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

2. Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm.

3. Nëse ligji i ri nuk e inkriminon veprën, por kryesi është dënuar me aktgjykim të formës së prerë në pajtim me ligjin e mëparshëm, sanksioni penal nuk fillon të ekzekutohet ose ndërpritet në rast se ka filluar.

4. Një ligj i cili shprehimisht ka qenë në fuqi vetëm për një kohë të caktuar, zbatohet për ato vepra penale që janë kryer gjatë kohës kur ai ligj ka qenë në fuqi edhe në rastin kur nuk është më në fuqi, përveç nëse vetë ligji shprehimisht përcakton ndryshe."

Neni 152
Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës

"1. Kushdo që shkel rëndë nenin 3, që është i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949, dënohet me burgim së paku pesë (5) vjet ose me burgim të përjetshëm.

2. Shkelje e rëndë e nenit 3, të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12 Gushtit 1949, do të thotë një ose më shumë nga veprat e mëposhtme të kryera në kontekstin e një konflikti të armatosur jo të një karakteri ndërkombëtar kundër personave që nuk marrin pjesë aktive në armiqësi, duke përfshirë edhe pjesëtarët e forcave të armatosura që i kanë dorëzuar armët dhe që nuk janë në gjendje të luftojnë për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit ose për ndonjë shkak tjetër:

2.1. dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasja e çdo lloji, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura;

2.2. kryerja e akteve fyese ndaj dinjitetit të personit, në veçanti poshtërimi dhe trajtimi nënçmues;

2.3. marrja e pengjeve;

2.4. shqiptimi i dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa aktgjykime paraprake të shpallura nga një gjykatë e rregullt që ofron të gjitha garancitë gjyqësore të cilat përgjithësisht njihen si të domosdoshme.

3. Ky nen zbatohet për konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar dhe nuk zbatohet për situatat e çrregullimeve dhe tensioneve të brendshme, siç janë trazirat, veprat sporadike dhe të izoluara të dhunës ose vepra të tjera të natyrës së ngjashme."

Neni 153
Krimet e luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar

1. Kushdo që shkel rëndë ligjet dhe zakonet që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar, brenda kornizës së përcaktuar të së drejtës ndërkombëtare, dënohet me:

1.1. burgim prej së paku pesë (5) vjet ose me burgim të përjetshëm, për veprat penale nga nën
paragrafët 2.4, 2.5, 2.7, 2.12, 2.23 ose 2.24 të paragrafit 2. të këtij neni; ose

1.2. burgim prej së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm, për veprat penale nga nën paragrafët 2.1, 2.2, 2.3, 2.6, 2.8, 2.9, 2.10, 2.11, 2.13, 2.14, 2.15, 2.16, 2.17, 2.18, 2.19, 2.20, 2.21 ose 2.22 të paragrafit 2. të këtij neni.

2. Shkelja e rëndë e ligjeve dhe e zakoneve që zbatohen për konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar, brenda kornizës së përcaktuar të së drejtës ndërkombëtare, nënkupton një ose më shumë nga veprimet vijuese:

2.1. sulmet e drejtuara me qëllim kundër popullsisë civile ose ndaj individëve të veçantë civilë që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në konflikt;

2.2. drejtimi me qëllim i sulmeve kundër ndërtesave, materialeve, njësive mjekësore dhe transportit, personelit fetar dhe personelit që përdorin shenjën dalluese të Konventave të Gjenevës në pajtim me të drejtën ndërkombëtare;

2.5. plaçkitja e një qyteti ose e një vendi, qoftë edhe kur merret me anë të sulmit;

2.8. urdhërimi për zhvendosjen e popullatës civile për shkaqe që lidhen me konfliktin, përveç kur kjo kërkohet për shkak të sigurisë së civilëve të përfshirë ose për shkaqe imperative ushtarake;

2.13. sulmi ose bombardimi me çfarëdo mjete i qyteteve, fshatrave, vendbanimeve ose ndërtesave që janë të pambrojtura dhe të cilat nuk janë objektiva ushtarake;

KODI NR. 06/L-074
KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 3
Zbatimi i ligjit më të favorshëm

"1. Ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

2. Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm.

3. Nëse ligji i ri nuk e inkriminon veprën, por kryesi është dënuar me aktgjykim të formës së prerë në pajtim me ligjin e mëparshëm, sanksioni penal nuk fillon të ekzekutohet ose ndërpritet në rast se ka filluar.

4. Një ligj i cili shprehimisht ka qenë në fuqi vetëm për një kohë të caktuar, zbatohet për ato vepra penale që janë kryer gjatë kohës kur ai ligj ka qenë në fuqi edhe në rastin kur nuk është më në fuqi, përveç nëse vetë ligji shprehimisht përcakton ndryshe."

Neni 146
Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës

"1. Kushdo që shkel rëndë nenin 3, që është i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949, dënohet me burgim së paku pesë (5) vjet ose me burgim të përjetshëm.

2. Shkelje e rëndë e nenit 3, të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12 Gushtit 1949, do të thotë një ose më shumë nga veprat e mëposhtme të kryera në kontekstin e një konflikti të armatosur jo të një karakteri ndërkombëtar kundër personave që nuk marrin pjesë aktive në armiqësi, duke përfshirë edhe pjesëtarët e forcave të armatosura që i kanë dorëzuar armët dhe që nuk janë në gjendje të luftojnë për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit ose për ndonjë shkak tjetër:

2.1. dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasja e çdo lloji, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura;

2.2. kryerja e akteve fyese ndaj dinjitetit të personit, në veçanti poshtërimi dhe trajtimi nënçmues;

2.3. marrja e pengjeve;

2.4. shqiptimi i dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa aktgjykime paraprake të shpallura nga një gjykatë e rregullt që ofron të gjitha garancitë gjyqësore të cilat përgjithësisht njihen si të domosdoshme.

3. Ky nen zbatohet për konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar dhe nuk zbatohet për situatat e çrregullimeve dhe tensioneve të brendshme, siç janë trazirat, veprat sporadike dhe të izoluara të dhunës ose vepra të tjera të natyrës së ngjashme."

Neni 147
Krimet e luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar

"1. Kushdo që shkel rëndë ligjet dhe zakonet që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar, brenda kornizës së përcaktuar të së drejtës ndërkombëtare, dënohet me:

1.1. burgim prej së paku pesë (5) vjet ose me burgim të përjetshëm, për veprat penale nga nën paragrafët 2.4, 2.5, 2.7, 2.12, 2.23 ose 2.24 të paragrafit 2. të këtij neni; ose

1.2. burgim prej së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm, për veprat penale nga nën paragrafët 2.1, 2.2, 2.3, 2.6, 2.8, 2.9, 2.10, 2.11, 2.13, 2.14, 2.15, 2.16, 2.17, 2.18, 2.19, 2.20, 2.21 ose 2.22 të paragrafit 2. të këtij neni.

2. Shkelja e rëndë e ligjeve dhe e zakoneve që zbatohen për konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar, brenda kornizës së përcaktuar të së drejtës ndërkombëtare, nënkupton një ose më shumë nga veprimet vijuese:

2.1. sulmet e drejtuara me qëllim kundër popullsisë civile ose ndaj individëve të veçantë civilë që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në konflikt;

2.2. drejtimi me qëllim i sulmeve kundër ndërtesave, materialeve, njësive mjekësore dhe transportit, personelit fetar dhe personelit që përdorin shenjën dalluese të Konventave të Gjenevës në pajtim me të drejtën ndërkombëtare;

2.5. plaçkitja e një qyteti ose e një vendi, qoftë edhe kur merret me anë të sulmit;

2.8. urdhërimi për zhvendosjen e popullatës civile për shkaqe që lidhen me konfliktin, përveç kur kjo kërkohet për shkak të sigurisë së civilëve të përfshirë ose për shkaqe imperative ushtarake;

2.13. sulmi ose bombardimi me çfarëdo mjete i qyteteve, fshatrave, vendbanimeve ose ndërtesave që janë të pambrojtura dhe të cilat nuk janë objektiva ushtarake."

KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURES PENALE (publikuar në Gazetën Zyrtare më 28 dhjetor 2012)

Neni 61
Të drejtat e mbrojtësit si përfaqësues i të pandehurit

"1. Mbrojtësi gëzon të drejta të njëjta që ia njeh ligji edhe të pandehurit, përveç atyre që shprehimisht i rezervohen të pandehurit personalisht.

2. Mbrojtësi ka të drejtë të komunikojë lirisht me të pandehurin gojarisht ose me shkrim sipas kushteve që garantojnë fshehtësinë.

3. Mbrojtësi ka të drejtë të njoftohet me kohë për vendin dhe kohën e zbatimit të veprimeve hetimore, të marrë pjesë në to dhe të shikojë shkresat dhe provat e çështjes në pajtim me dispozitat e këtij Kodi."

Neni 120
Identifikimi i personave apo sendeve

"1. Kur është e nevojshme të vendoset se një dëshmitar a e njeh personin ose sendin, nga dëshmitari i tillë së pari kërkohet të përshkruajë dhe tregojë tiparet dalluese të personit ose të sendit të tillë.

2. Dëshmitarit pastaj i tregohet personi me persona të tjerë të panjohur për dëshmitarin ose fotografitë e tyre apo sendi me sende të tjera të llojit të njëjtë ose fotografitë e tyre.

3. Dëshmitarit i bëhet me dije se nuk detyrohet të zgjedhë personin ose sendin apo ndonjë fotografi dhe se është po aq e rëndësishme për të treguar se nuk e njeh personin, sendin ose fotografinë ashtu sikurse të thoshte se e njeh.

4. Procesverbali mbahet për përshkrimin e marrë sipas paragrafit 1 të këtij neni, përfshirë kohën dhe datën e këtij përshkrimi dhe personat e pranishëm me rastin e këtij përshkrimi. Procesverbali mbahet edhe për përshkrimin sipas paragrafit 2. të këtij neni, përfshirë kohën dhe datën e identifikimit dhe fotografitë e personave apo sendeve tjera.
5. Identifikimi i peronit apo sendit nga ky nen mund të mbikëqyret nga policia apo nga prokurori i shtetit. Procesverbali nga paragrafi 3. të këtij neni futet në shkresat e lëndës."

Neni 132
Marrja e deklaratës në procedurë paraprake

"1. Gjatë fazës së hetimit, prokurori i shtetit thërret dëshmitarët, viktimat, ekspertët dhe të

pandehurin apo të pandehurit për të dhënë deklaratë në procedurë paraprake lidhur me procedurën penale.

2. Gjatë fazës së hetimit, prokurori i shtetit merr në pyetje dëshmitarët e mbrojtur dhe dëshmitarët bashkëpunues duke siguruar sigurinë e përshtatshme për ta.

3. Dëshmitari thirret duke ia dërguar thirrjen me shkrim në të cilën shënohet emir, mbiemri dhe profesioni i dëshmitarit, koha dhe vendi ku duhet të paraqitet, lënda penale për të cilën thirret, shënimi se thirret si dëshmitar dhe paralajmërimi për pasojat e mungesës pa arsye.

4. Thirrja si dëshmitar e personit që nuk ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet bëhet nëpërmjet prindërve të tij apo përfaqësuesit ligjor, përveç kur kjo nuk është e mundur për shkak të nevojës për veprim të ngutshëm ose për shkak të rrethanave të tjera.

5. Dëshmitari i cili për shkak të pleqërisë, sëmundjes ose të metave të rënda trupore nuk mund t'i përgjigjet thirrjes, mund të pyetet jashtë gjykatës.

6. Prokurori i shtetit e njofton me shkrim pesë (5) ditë më herët të pandehurin, mbrojtësin, të dëmtuarin dhe mbrojtësin e viktimave lidhur me datën, kohën dhe vendin ku do të merret deklarata në procedurë paraprake. Kopje e njoftimit i bashkëngjitet shkresave të lëndës.

7. Mospjesëmarrja e pajustifikuar e të pandehurit, mbrojtësit, të dëmtuarit apo mbrojtësit të viktimave në seancën për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake, pasi të ketë pranuar njoftimin nga paragrafi 6, ia mohon atij të pandehuri, mbrojtësi, të dëmtuari apo mbrojtësi të viktimës që të kundërshtojë pranueshmërinë e dëshmisë në një fazë të mëvonshme të procedurës penale. Këto pasoja ceken në njoftimin nga paragrafi 6. të këtij neni."

Neni 288
Kërkesat pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor

"1. Palët, mbrojtësi dhe i dëmtuari edhe pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor mund të kërkojnë që në shqyrtim gjyqësor të thirren dëshmitarë dhe ekspertë të rinj ose të mblidhen prova të reja. Kërkesa e palëve duhet të jetë e arsyetuar dhe të shënojë se cilat fakte duhet provuar dhe me cilat prova të propozuara.

2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues aprovon kërkesën nga paragrafi 1. i këtij neni nëse dëshmitari i ri, eksperti i ri apo prova e re ka qenë e panjohur në kohën e shqyrtimit të dytë, ose nuk e përsërit në mënyrë të konsiderueshme dëshmitarin, ekspertin apo provën tjetër dhe edrejta e të pandehurit në gjykim të drejtë mund të dëmtohet duke refuzuar kërkesën.

3. Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e refuzon kërkesën për mbledhjen e provave të reja, refuzimi i tillë mund të ankimohet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i urdhrit për refuzimin e kërkesës.

4. Palët dhe mbrojtësi njoftohen për vendimin me të cilin urdhërohet mbledhja e provave të reja para fillimit të shqyrtimit gjyqësor."

Neni 350
Ndryshimi i aktakuzës në shqyrtim gjyqësor

"1. Kur prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor konstaton se provat e shqyrtuara tregojnë se gjendja faktike e paraqitur në aktakuzë është ndryshuar, ai në shqyrtim gjyqësor mund ta ndryshojë aktakuzën gojarisht dhe mund të propozojë që shqyrtimi gjyqësor të ndërpritet për përgatitjen e aktakuzës së re.

2. Nëse trupi gjykues lejon ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor për përgatitjen e aktakuzës së re, atëherë cakton afatin kur prokurori i shtetit detyrohet të paraqesë aktakuzën e re. Të akuzuarit i dërgohet kopja e aktakuzës së re. Nëse prokurori i shtetit në afatin e caktuar nuk paraqet aktakuzë të re, gjykata vazhdon shqyrtimin gjyqësor në bazë të aktakuzës së mëparshme.

3. Kur ndryshohet aktakuza, i akuzuari ose mbrojtësi mund të propozojnë ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor për përgatitjen e mbrojtjes. Trupi gjykues mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor për përgatitjen e mbrojtjes kur thelbi i aktakuzës është ndryshuar ose është zgjeruar."

Neni 351
Zgjerimi i aktakuzës në shqyrtimin gjyqësor

"1. Nëse i akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor kryen vepër penale ose nëse vepra penale e mëparshme e të akuzuarit zbulohet gjatë shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues në shqyrtimin gjyqësor mund të përfshijë edhe këtë vepër në bazë të akuzës së prokurorit të shtetit, e cila mund të paraqitet edhe gojarisht.

2. Në rastin e tillë, gjykata mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor për t'i dhënë kohë mbrojtjes për t'u përgatitur, e pas dëgjimit të palëve, mund të vendosë që për veprën nga paragrafi 1. i këtij neni të gjykojë veçmas të akuzuarin.

3. Nëse për gjykimin e çështjes nga paragrafi 1. i këtij neni është kompetent departamenti tjetër në kuadër të gjykatës themelore, trupi gjykues, pas dëgjimit të palëve, vendos se a do t'ia dërgojë çështjen për të cilën është duke e drejtuar shqyrtimin gjyqësor gjykatës drejtpërdrejt më të lartë kompetente për të marrë vendim."

Neni 384
Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

"1. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet nëse:

1.1. përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin ose kur në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ose kur me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi;

1.2. në shqyrtim gjyqësor ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet;

1.3. shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve në shqyrtim gjyqësor kërkohet me ligj, ose kur të akuzuarit apo mbrojtësit, pavarësisht nga kërkesa e tij, i është mohuar përdorimi i gjuhës së vet në shqyrtim gjyqësor dhe përcjellja e zbatimit të shqyrtimit gjyqësor në gjuhën e tij;

1.4. publiku është përjashtuar nga shqyrtimi gjyqësor në kundërshtim me ligjin;

1.5. gjykata ka shkelur dispozitat e procedurës penale lidhur me çështjen nëse ekziston akuza e prokurorit të autorizuar, propozimi i të dëmtuarit ose leja e organit publik kompetent;

1.6. aktgjykimin e ka marrë gjykata e cila nuk ka pasur kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes.

1.7. gjykata me aktgjykim nuk e ka gjykuar plotësisht lëndën e akuzës;

1.8. aktgjykimi bazohet në provë të papranueshme;

1.9. i akuzuari i thirrur të deklarohet mbi fajësinë nuk e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës ose ndonjë pikë të saj dhe është marrë në pyetje para prezentimit të provave;

1.10. aktgjykimi ka tejkaluar akuzën;

1.11. me aktgjykim është shkelur dispozita e nenit 395 të këtij Kodi; ose

1.12. aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 të këtij Kodi.

2. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet edhe kur gjatë procedurës
penale, duke përfshirë edhe procedurën paraprake, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia:

2. 1. nuk kanë zbatuar ndonjë dispozitë të këtij kodi ose kanë zbatuar gabimisht; ose

2.2. kanë shkelur të drejtat e mbrojtjes, dhe kjo ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë."

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

46. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

48. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve, 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

49. Në vlerësimin e përmbushjes së kritereve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka specifikuar se konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Pml.nr.19/2022] të 5 shkurtit 2022, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

50. Siç është cekur në hyrje të këtij vendimi, Gjykata përsëritë se në procedurën e zhvilluar kundër parashtruesit të kërkesës janë nxjerrë tri vendime të Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme-që kontestohen nga parashtruesi i kërkesës- e që po ashtu do të jenë objekt vlerësimi kushtetues nga kjo Gjykatë: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore [ST.nr.15/19] i 11 shkurtit 2021 dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit [APS.nr.22/2021] i 12 tetorit 2021 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [Pml.nr.19/2022] i 5 shkurtit 2022.

51. Gjykata gjithashtu konsideron se kërkesa nuk mund të konsiderohet qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç parashihet me paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, dhe për pasojë, kërkesa shpallet e pranueshme për shqyrtim në merita. (shih, gjithashtu rastin e GJEDNJ-së, *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, nr. 20134/05, Aktgjykim i 9 korrikut 2012, paragrafi 144, si dhe shih rastet e Gjykatës KI75/21, parashtrues *"Abrazen LLC", "EnergyDevelopmentGroup Kosova LLC", "Alsi&Co. Kosovë LLC" dhe "BuildingConstruction LLC"*, Aktgjykim i 19 janarit 2022, paragrafi 64;KI27/20, parashtrues, *Lëvizja VETËVENDOSJE!*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, paragrafi 43).

Meritat e kërkesës

52. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (3) a) dhe d) të KEDNJ-së dhe nenin 9 (2) të KNDCP-së.

53. Gjykata thekson se thelbi i rastit ndërlidhet me aktakuzën që Prokuroria Speciale Republikës së Kosovës kishte ngritur kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të veprës penale Krim lufte që përbënë shkelje të rëndë të nenit 3 të Konventave të Gjenevës, në pajtim me nenin 152 paragrafi 1 KPK-së dhe nenit 142 të Ligjit penal të RSFJ-së, krimet të luftës që përbëjnë shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konflikte të armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar që ndiqen në bazë të dispozitave përkatëse të KPK-së. Gjykata Themelore e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Krime të Luftës Kundër Popullatës Civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, lidhur me nenin 3 të Konventës së

Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe nenin 4 të Protokollit 2 të 8 qershorit 1977, Shtojcë e Konventës së Gjenevës, duke e gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) vitesh me të cilin dënim llogaritet edhe koha e qëndrimit në paraburgim. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit dënues të Gjykatës Themelore duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe vendimit për dënimin dhe shpenzimet e procedurës. Gjykata e Apelit refuzoi të pabazuar ankesën dhe e vërtetoi Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit përfundoi se konkludimet e gjykatës së shkallës së parë janë të qarta dhe në pajtueshmëri me provat e administruara, vlerësoi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale të theksuara nga parashtruesi i kërkesës Gjykata e Apelit kujdeset zyrtarisht, nuk konstatohet vërtetim i gabuar dhe i jo i plotë i gjendje faktike, si dhe nuk konstatohet aplikim i gabuar i ligji penal. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë kërkesën të bazuar dhe të nxjerrë aktgjykim me të cilin do të ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara, ashtu që parashtruesin e kërkesës ta lirojë nga akuza ose aktgjykimet t'i anulojë dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje. Gjykata Supreme refuzoi të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

54. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ngre pretendime lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (3) a) dhe d) të KEDNJ-së: **(i)** për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 (3) (a) të KEDNJ-së sepse prokuroria dhe gjykatat e rregullta nuk ia dhanë mundësinë parashtruesit të kërkesës që të deklarohet për aktakuzën e ndryshuar dhe të zgjeruar kundër tij; **(ii)** për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 (3) (a) të KEDNJ-së dhe duke iu referuar nenit 61, paragrafi 3 [Të drejtat e mbrojtësit si përfaqësues i të pandehurit] sepse veprimet hetimore-marrja në pyetje e dëshmitarëve, palëve të dëmtuara, identifikimi i të akuzuarit-parashtruesit të kërkesës, janë kryer pa praninë e mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës; **(iii)** për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 (3) d) të KEDNJ-së duke iu referuar nenit 288, paragrafi 2 i KPPRK-së, sepse propozimi i dëshmitarëve të rinj mund të pranohet vetëm nëse dëshmitarët e propozuar nuk janë njohur në kohën e mbajtjes së shqyrtimit të dytë fillestar; **(iv)** për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 (3) d) të KEDNJ-së sepse gjykatat nuk kanë dëgjuar dëshmitarët që do të kishin dëshmuar në favor të parashtruesit të kërkesës ose të paktën dëshmia e tyre do të ishte neutrale.

55. Gjatë vlerësimit të meritave të rastit nën shqyrtim, Gjykata do të zbatojë standardet e praktikës gjyqësore GJEDNJ-së, që në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar që të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë t'i interpretojë në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së.

Parimet e përgjithshme lidhur me nenin 6 (3) (a) dhe (d) të KEDNJ-së

56. Fushëveprimi i nenit 6 (3) (a) duhet të vlerësohet duke pasur parasysh të drejtën e përgjithshme për gjykim të drejtë të garantuar me neni 6 (1) të KEDNJ-së. Në rastet penale, ofrimi i informatave të plota dhe të detajuara lidhur me akuzën që ngarkon të pandehurin dhe rrjedhimisht karakterizimi ligjor që gjykata mund ta përvetësojë në atë rast, është parakusht thelbësorë për të garantuar që procedurat janë të drejta (shih rastet e GJEDNJ-së, *Pélissier dhe Sassi kundër Francës*, nr. 25444/94, Aktgjykim i 25 marsit 1999, paragrafi 52; *Sejdovic kundër Italisë*, nr. 56581/00, Aktgjykim i 1 marsit 2006, paragrafi 90).

57. Nën-paragrafët (a) dhe (b) të nenit 6 (3) janë të ndërlidhura ashtu që e drejta për të qenë i informuar për natyrën dhe shkakun e akuzës duhet të vlerësohet duke pasur parasysh të drejtën e të akuzuarit që ta përgatisë mbrojtjen e tij. (shih rastet e GJEDNJ-së, *Pélissier dhe Sassi kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 54; dhe *Dallos kundër Hungarisë*, nr.29082/95, Aktgjykim i 1 marsit 2001, paragrafi 47).

58. Neni 6 (3) (a) thekson nevojën për vëmendje të veçantë ndaj njoftimit për "akuzë" ndaj të pandehurit. Veçoritë e veprës penale luajnë rol të rëndësishëm në procesin penal, ashtu që nga çasti i njoftimit të akuzës i dyshuari zyrtarisht njoftohet me shkrim lidhur me bazën ligjore dhe faktike të akuzës që e ngarkon atë (shih rastet e GJEDNJ-së, *Pélissier dhe Sassi kundër Francës*, cituar më lart, 51; dhe *Kamasinski kundër Austrisë*, nr. 9783/82, Aktgjykim i 19 dhjetorit 1989, paragrafi 79).

59. Neni 6 (3) (a) i akordon të drejtën të pandehurit që të informohet për "shkakun" e akuzës, pra, veprat që ai pretendohet se ai i ka kryer dhe mbi të cilat bazohet akuza, si dhe "natyrën" e akuzës, pra, karakterizimi i ligjor i atyre veprave (shih rastet e GJEDNJ-së, *Mattoccia kundër Italisë*, nr. 23969/94, Aktgjykim i 25 korrikut 2000, paragrafi 59; dhe *Penev kundër Bullgarisë*, nr. 20494/04, Aktgjykim i 7 janarit 2010, paragrafët 33 dhe 42).

60. Neni 6 (3) (a) nuk cakton ndonjë kriter të veçantë formal lidhur me mënyrën sesi duhet të informohet i akuzuari për natyrën dhe shkakun e akuzës që e rëndon atë (shih rastet e GJEDNJ-së, *Pélissier dhe Sassi kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 53; dhe *Drassich kundër Italisë*, nr. 25575/04, Aktgjykim i 1 dhjetorit 2007, paragrafi 34) .Në këtë kontekst, akuza luan rol të rëndësishëm në procesin penal, ashtu që nga çasti i dërgimit të saj i pandehuri është zyrtarisht i njoftuar me shkrim lidhur me bazën ligjore dhe faktike të akuzës që e ngarkon atë (shih rastin e GJEDNJ-së *Kamasinski kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 79).

61. I akuzuari duhet të njoftohet drejtë dhe plotësisht lidhur me çdo ndryshim të akuzës, përfshirë ndryshimet për "shkakun", dhe duhet t'i ofrohet kohë e mjaftueshme dhe lehtësira *(facilities)* për të reaguar ndaj tyre si dhe ta organizojë mbrojtjen e tij bazuar në informatën apo pretendimin e ri (shih rastet e GJEDNJ-së, *Mattoccia kundër Italisë*, cituar më lart, paragrafi 61; dhe *Varela Geis kundër Spanjës*, nr. 61005/09, Aktgjykim i 5 marsit 2013, paragrafi 54).

62. Në rast të klasifikimit të fakteve gjatë zhvillimit të procedurave, të akuzuarit duhet t'i akordohet mundësia që t'i ushtrojë të drejtat e mbrojtjes së tij në mënyrë praktike dhe efektive dhe në kohën e duhur (shih rastet e GJEDNJ-së, *Pélissier dhe Sassi kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 62; *Block kundër Hungarisë*, nr. 56282/09, Aktgjykim i 2011, paragrafi 24; dhe *Haxhia kundër Shqipërisë*, nr. 29861/03, Aktgjykim i 8 tetorit 2013, paragrafët 137-138).

63. Defektet në njoftimin e akuzës mund të ndreqen në procedurë të ankimimit nëse të akuzuarit i akordohet mundësia që të avancojë mbrojtjen e tij para gjykatave të larta *(higher courts)* lidhur me akuzën e riformuluar dhe ta kontestojë dënimin e tij lidhur me të gjitha aspektet relevante ligjore dhe faktike (shih rastet e GJEDNJ-së, *Dallos kundër Hungarisë*, cituar më lart, paragrafët 49-52; *Sipavičius kundër Lituanisë*, nr.49093/99, Aktgjykim i 21 shkurtit 2002, paragrafët 30-33; *Zhupnik kundër Ukrainës*, nr. 20792/05, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2010, paragrafët 39-43; dhe *Gelenidze kundër Gjeorgjisë*, nr. 72916/10, Aktgjykim i 7 nëntorit 2019, paragrafi 30).

64. Duke qenë se pranueshmëria e dëshmive është çështje që rregullohet me ligjin vendor dhe gjykatat vendore, shqetësimi *(concern)* i vetëm i GJEDNJ-së nën nenin 6 (1) dhe 3 (d) të KEDNJ-së është që të hetojë *(examine)* nëse procedurat janë administruar me korrektësi (shih rastin e GJEDNJ-së, *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 26766/05 dhe 22228/06, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2011, paragrafi 118).

65. Sipas nenit 6 (3) (d) të KEDNJ-së, para se një i akuzuar të dënohet, të gjitha dëshmitë kundër tij duhet që zakonisht duhet të paraqiten *(produced)* në praninë e tij në një seancë publike për shkak të argumentimit kontradiktor. Përjashtimet nga ky parim janë të mundshme por nuk duhet që të cenojnë të drejtat e mbrojtjes, të cilat, si rregull, kërkojnë që të akuzuarit duhet t'i akordohet mundësi e mjaftueshme dhe e duhur *(adequate and proper)* për t'i kontestuar dhe t'i pyes kundërshtarët kundër tij, ose në çastin e deklarimit të atij dëshmitari ose në një fazë të mëvonshme të procedurave.(shih rastet e GJEDNJ-së, *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar* cituar më lart, paragrafi 118; *Hümmer kundër Gjermanisë*, nr. 26171/07, Aktgjykim i 19 korrikut 2012, paragrafi 38; dhe *Lucà kundër Italisë*, nr. 33354/96, Aktgjykim i 27 shkurtit 2001, paragrafi 39).

66. Duke konsideruar rëndësinë e administrimit të drejtë të drejtësisë në një shoqëri demokratike, çdo masë, që kufizon të drejtat e mbrojtjes duhet të jetë e domosdoshme *(strictly necessary)*. Nëse një masë më pak kufizuese mund të mjaftojë, atëherë ajo masë duhet të zbatohet (shih rastin e GJEDNJ-së, *Van Mechelen dhe tjerët kundër Holandës*, nr. 21363/93 21364/93 21427/93 dhe 22056/93, Aktgjykim i 30 tetorit 1997, paragrafi 58). Mundësia që i akuzuari të përballet me një dëshmitar material *(material witness)* në praninë e gjyqtarit është një element i rëndësishëm i gjykimit të drejtë (shih rastet e GJEDNJ-së, *Tarău kundër Rumanisë*, nr. 3584/02, Aktgjykim i 24 shkurtit 2009, paragrafi 74; dhe *Graviano kundër Italisë*, nr. 10075/02, Aktgjykim i 10 shkurtit 2005, paragrafi 38).

67. Si rregull i përgjithshëm, u takon gjykatave vendore që të vlerësojnë dëshmitë para tyre si dhe relevancën e dëshmive që i akuzuari dëshiron t'i nxjerrë. Neni 6 (3) (d) i KEDNJ-së, u lë gjykatave vendore, që të vlerësojnë nëse nevojitet thirrja e dëshmitarëve. Nuk kërkohet paraqitja dhe marrjes në pyetje *(attendance and examination)* i secilit dëshmitar në emër të të akuzuarit; qëllimi themelor i tij, siç edhe tregohet nga fjalia "nën kushte të njëjta", është barazia e plotë e armëve në çështjen penale (shih rastet e GJEDNJ-së, *Perna kundër Italisë*, nr.48898/99, Aktgjykim i 2003, paragrafi 29; *Murtazaliyeva kundër Rusisë*, nr. 36658/05, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2018, paragrafi 139; dhe *Solakov kundër ish Republikë Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 47023/99, Aktgjykim i 31 tetorit 2001, paragrafi 57).

68. Neni 6 i KEDNJ-së nuk i akordon të akuzuarit të drejtë të pakufizuar për të siguruar paraqitjen e dëshmitarëve në gjykatë. Zakonisht u takon gjykatave vendore për të vendosur nëse është e nevojshme apo e kështillueshme që të hetohet një dëshmitar (shih rastin e GJEDNJ-së, *S.N. kundër Suedisë*, nr. 34209/96, Aktgjykim i 2 korrikut 2002, paragrafi 44). Megjithatë, kur një gjykatë e faktit *(trial court)* akordon kërkesën për thirrjen e dëshmitarit mbrojtës, është e obliguar të ndërmarrë masa efektive për të siguruar praninë e dëshmitarit në seancë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Polufakin dhe Chernyshev kundër Rusisë*, nr. 30997/02, Aktgjykim i 25 shtatorit 2008, paragrafi 207), së paku, duke i ftuar ose urdhëruar policinë që të detyrojë dëshmitarin që të paraqitet në gjykatë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Murtazaliyeva kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafi 147).

69. Nuk është e mjaftueshme që një i pandehur të ankohet se atij nuk i është lejuar t'i pyes dëshmitarët e caktuar; për më tepër, ai duhet, të mbështesë kërkesën e tij duke shpjeguar përse është e rëndësishme që dëshmitarët në fjalë të dëgjohen, dhe se

dëshmia e tyre duhet të jetë e domosdoshme për konstatimin e të vërtetës dhe të drejtat e mbrojtjes (shih rastet e GJEDNJ-së, *Perna kundër Italisë*, cituar më lart, paragrafi 29; dhe *Băcanu dhe SC «R» S.A. kundër Rumanisë*, nr. 4411/04, Aktgjykim i 3 marsit 2009, paragrafi 75). Nëse deklaratat e dëshmitarëve që ankuesi ka dëshiruar t'i thërras nuk mund të ndikojnë në rezultatin e rastit të tij, asnjë problem nuk ngrehet nën nenin 6 (1) dhe 3 (d) të KEDNJ-së, në rastet kur kërkesa për ta dëgjuar dëshmitarin e tillë refuzohet nga gjykatat vendore (shih rastin e GJEDNJ-së, *Kapustyak kundër Ukrainës*, nr. 26230/11, Aktgjykim i 3 marsit 2016, paragrafët 94-95).

70. Kur kërkesa e të pandehurit për të marrë në pyetje dëshmitarët nuk është e bezdisshme *(vexatious)*, është mjaftueshëm e arsyetuar, është relevant për objektin e çështjes të dhe që argumentohet se mund ta fuqizojë pozitën e mbrojtjes ose madje të çojë deri tek lirimi i tij, autoritetet vendore duhet që të ofrojnë arsye relevante për të hedhur poshtë kërkesën e tillë (shih rastet e GJEDNJ-së, *Vidal kundër Belgjikës*, nr. 12351/96, Aktgjykim i 28 tetorit 1992, paragrafi 34; *Sergey Afanasyev kundër Ukrainës*, nr. 48057/06, Aktgjykim i 2012, paragrafi 70; dhe *Topić kundër Kroacisë*, nr. 51355/10, Aktgjykim i 10 tetorit 2013, paragrafi 42).

Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

71. Gjykata rithekson se nuk është detyra e saj që t'i zëvendësojë gjykatat e rregullta, që janë në pozitë më të mirë për t'i vlerësuar provat në dispozicionin e tyre, t'i konstatojnë faktet dhe interpretojnë të drejtën vendore (shih, për shembull, rastin e GJEDNJ-së, *Khamidov kundër Rusisë*, nr. 72118/01, Aktgjykim i 15 nëntorit 2007, paragrafi 170). Gjykata thekson se kur bëhet fjalë për konstatimin e fakteve dhe interpretimin e ligjit, është e "ndjeshme" për natyrën subsidiare të rolit të saj dhe se duhet të jetë e kujdesshme në marrjen e rolit të gjykatës së faktit, veçse kur një gjë e tillë është bërë e pashmangshme nga rrethanat e rastit (shih, për shembull, rastin e GJEDNJ-së, *Bărbulescu kundër Rumanisë*, nr. 61496/08, Aktgjykim i 2017, paragrafi 129).

72. Gjykata thekson se në praktikën e saj gjyqësore në shumë raste ka konstatuar se çështjet e faktit dhe çështjet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit janë brenda fushëveprimit të gjykatave të rregullta dhe të autoriteteve të tjera publike, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe si të tilla janë çështje të ligjshmërisë, përveç dhe përderisa, çështje të tilla rezultojnë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ose krijojnë një situatë antikushtetuese. Pavarësisht nga hapësira e vlerësimit të gjykatave të rregullta, vendimi përfundimtar lidhur me respektim të kritereve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së ngelet tek Gjykata Kushtetuese.

(i) *Përkitazi me pretendimin për ndryshim dhe zgjerim të aktakuzës (neni 31 i Kushtetutës, neni 6-3-a i KEDNJ-së)*

73. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 (3) a) të KEDNJ-së për shkak se prokuroria dhe gjykatat e rregullta nuk ia dhanë mundësinë parashtruesit të kërkesës që të deklarohet për aktakuzën e ndryshuar dhe të zgjeruar kundër tij, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit ka shpjeguar: **(i)** Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se kjo situatë bën fjalë për ndryshim dhe zgjerim të aktakuzës e cila bëhet në kuptim të nenit 351 të KPPRK-së, si rezultat i provave dhe fakteve që rezultojnë në shqyrtimin kryesor, theksimi se janë shkelur dispozitat imperative nga neni 241 par.1.1.7 të KPPRK-së të cilat kërkojnë që aktakuza të përmbajnë arsyetimin është i paqëndrueshëm; **(ii)** në këtë rast, sipas pikëpamjes së prokurorit kanë derivuar fakte të reja që kanë kushtëzuar ndryshimin dhe zgjerimin e akuzës, njëkohësisht prokurori i ka dhënë të parashtruesit të kërkesës, në kohë, dhe me qartësi informacion që detajizon bazën faktike mbi të cilën janë ndryshuar dhe zgjeruar akuzat kundër tij; **(iii)** ekziston dallueshmëria me rastin e ndryshimit dhe zgjerimit të

akuzës në këtë momentum procedural, në dallim prej ngritjes së aktakuzës fillestare, në këtë aspekt aktakuza mund të ndryshohet dhe zgjerohet edhe gojarisht në procesverbal apo të propozohet ndërprerja për përgatitjen e aktakuzës se re; **(iv)** megjithatë në çdo situatë është detyrë e gjykatës është që t'i ofrojë mundësi dhe kohë mbrojtjes që të përgatitet, nga procesverbali i shqyrtimit kryesor konstatohet se një mundësi e tillë i është dhënë mbrojtjes së parashtruesit të kërkesës; **(v)** për të përcaktuar nëse kishte tejkalim të akuzës, veprimet e parashtruesit të kërkesës për të cilën ngarkohet ai sipas aktgjykimit duhet vështruar në kuadër të tërësishëm të veprimeve inkriminuese të ngjarjes të përshkruara në aktakuzën e ndryshuar, dhe jo duke e shkëputur vetëm këtë fragment si të izoluar nga ngjarja dhe rrjedha e saj në relacion me viktimën B.B. **(vi)** fakti se gjykata në aktgjykim ka konstatuar një fakt të tillë në bazë të dëshmisë së të dëmtuarës V.B., nuk konsiderohet tejkalim i aktakuzës për arsye se: **a)** nuk ndryshohet kualifikimi juridik i veprës penale (cilësimi për një vepër më të rëndë penale, apo vepër penale me natyrë tjetër dhe jashtë kapitullit për të cilën akuzohet); **b)** nuk ndryshohet roli i tij në kryerjen e veprës penale, sipas aktakuzës dhe aktgjykimit pasi që akuzuari akuzohet si bashkëkryes me persona tjerë dhe ka mbetur i tillë edhe sipas aktgjykimit; **c)** ndryshimi konsiston në kuadër të ngjarjes së njëjtë penale që ka ndodhur dhe në pajtueshmëri me rezultatin provues të cilën trupi gjykues veprimet e caktuara inkriminuese i ka konstatuar si të provuara.

74. Nga sa më sipër, Gjykata i referohet bazës ligjore përkatësisht nenit 350.1 [Ndryshimi i aktakuzës në shqyrtim gjyqësor] dhe 351.1 [Zgjerimi i aktakuzës në shqyrtimin gjyqësor] të KPPRK-së që i janë referuar prokuroria dhe gjykatat lidhur me ndryshimin dhe zgjerimin e aktakuzës: "*350.1. Kur prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor konstaton se provat e shqyrtuara tregojnë se gjendja faktike e paraqitur në aktakuzë është ndryshuar, ai në shqyrtim gjyqësor mund ta ndryshojë aktakuzën gojarisht dhe mund të propozojë që shqyrtimi gjyqësor të ndërpritet për përgatitjen e aktakuzës së re. "351.1. Nëse i akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor kryen vepër penale ose nëse vepra penale e mëparshme e të akuzuarit zbulohet gjatë shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues në shqyrtimin gjyqësor mund të përfshijë edhe këtë vepër në bazë të akuzës së prokurorit të shtetit, e cila mund të paraqitet edhe gojarisht.*"

75. Përkitazi me pretendimin për zgjerim të aktakuzës, Gjykata vë në pah arsyetimin relevant të Gjykatës së Apelit: "*Kolegji vlerëson se kjo situatë bën fjalë për ndryshim dhe zgjerim të aktakuzës e cila bëhet në kuptim të nenit 351 të KPPRK-së, si rezultat i provave dhe fakteve që rezultojnë në shqyrtimin kryesor, theksimi se janë shkelur dispozitat imperative nga neni 241 par.1.1.7 të KPPRK-së të cilat kërkojnë që aktakuza të përmbajnë arsyetimin është i paqëndrueshëm. Dispozita e tillë trajton aktakuzën fillestare të paraqitur, por jo çështjen e ndryshimit dhe zgjerimit të saj në shqyrtimin kryesor, prandaj situata procedurale konkrete e ngritur është jashtë domenit të rregullimit të kësaj dispozite. Në rastin aktual, sipas pikëpamjes së prokurorit kanë derivuar fakte të reja që kanë kushtëzuar ndryshimin dhe zgjerimin e akuzës, njëkohësisht prokurori i ka dhënë të akuzuarit, në kohë, dhe me qartësi informacion që detajizon bazën faktike mbi të cilën është ndryshuar dhe zgjeruar akuzat kundër tij. Ekziston dallueshmëria me rastin e ndryshimit dhe zgjerimit të akuzës në këtë momentum procedural, në dallim prej ngritjes se aktakuzës fillestare, në këtë aspekt aktakuza mund të ndryshohet dhe zgjerohet edhe gojarisht në procesverbal apo të propozohet ndërprerja për përgatitjen e aktakuzës se re. Megjithatë në çdo situatë është detyrë e gjykatës është që t'i ofrojë mundësi dhe kohë mbrojtjes që të përgatitet, nga procesverbali i shqyrtimit kryesor konstatohet se një mundësi e tillë i është dhënë mbrojtjes.*"

76. Veç kësaj, lidhur me pozitën e parashtruesit të kërkesës pas zgjerimit të aktakuzës, Gjykata po ashtu vëren se Gjykata e Apelit kishte theksuar: "*a) nuk ndryshohet kualifikimi juridik i veprës penale (cilësimi për një vepër më të rëndë penale, apo vepër*

penale me natyrë tjetër dhe jashtë kapitullit për të cilën akuzohet); b) nuk ndryshohet roli i tij në kryerjen e veprës penale, sipas aktakuzës dhe aktgjykimit pasi që akuzuari akuzohet si bashkëkryes me persona tjerë dhe ka mbetur i tillë edhe sipas aktgjykimit; dhe c) ndryshimi konsiston në kuadër të ngjarjes së njëjtë penale që ka ndodhur, dhe në pajtueshmëri me rezultatin provues të cilën trupi gjykues veprimet e caktuara inkriminuese i ka gjetur si të provuar."

77. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata e Apelit ka shpjeguar se: **(i)** prokurori me kohë ka njoftuar mbrojtësin e parashtruesit të kërkesës lidhur me zgjerimin e aktakuzës çka edhe është konstatuar gjatë procesit gjyqësorë nga Gjykata e Apelit se mundësia e ushtrimit praktik dhe efektiv të mbrojtjes ndaj zgjerimit të aktakuzës i është dhënë mbrojtjes së parashtruesit të kërkesës e (shih rastet e GJEDNJ-së, *Pélissier dhe Sassi kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 62; *Block kundër Hungarisë*, cituar më lart, paragrafi 24; *Haxhia kundër Shqipërisë*, cituar më lart, paragrafët 137-138); **(ii)** çfarëdo defekti të pretenduar që mund të ketë pasur lidhur me zgjerimin e aktakuzës është ndrequr në fazën e mëvonshme në procedurën e apelit (shih rastet e GJEDNJ-së, *Dallos kundër Hungarisë*, cituar më lart, paragrafët 49-52; *Sipavičius kundër Lituanisë*, cituar më lart, paragrafët 30-33; *Zhupnik kundër Ukrainës*, cituar më lart, paragrafët 39-43; dhe *Gelenidze kundër Gjeorgjisë*, cituar më lart, paragrafi 30); **(iii)** zgjerimi i aktakuzës kundër parashtruesit të kërkesës, nuk ka ndryshuar kualifikimin e veprës penale dhe nuk ka ndryshuar rolin e parashtruesit të kërkesës në kryerjen e veprës penale dhe rrjedhimisht ka qenë mjaftueshëm e parashikueshme për parashtruesin e kërkesës sepse përbën element thelbësor *(intrinsic)* të aktakuzës (shih rastet e GJEDNJ-së, *De Salvador Torres kundër Spanjës*, nr. 21525/93, Aktgjykim i 1996, paragrafi 33; dhe *Sadak dhe tjerët kundër Turqisë (nr.1)*, nr. 29900/96 29901/96 29902/96 29903/96 Aktgjykim i 17 korrikut 2001, dhe 52 dhe 56).

78. Në këtë kontekst, Gjykata vë në pah edhe arsyetimin e Gjykatës Supreme: *"Ndryshimi i aktakuzës konsiston në kuadër të ngjarjes së njëjtë penale që ka ndodhur, dhe në pajtueshmëri me rezultatin provues, gjykata e shkallës së parë në aktgjykim ka konstatuar një version të ngjarjes që është ma favorizues për të akuzuarin, përkatësisht se ndaj viktimës ka shtënë një pjesëtar i grupit të armatosur, prandaj në tërësinë e saj parashtruesit të kërkesës nuk i është vështirësuar gjendja në raport me vëllimin inkriminues që është akuzuar sipas aktakuzës së ndryshuar dhe zgjeruar. Nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimet e kundërshtuara rezulton se gjykatat i kanë dhënë mundësi dhe kohë parashtruesit të kërkesës që të përgatitet, e kjo konstatohet nga procesverbali i shqyrtimit kryesor se një mundësi e tillë i është dhënë të akuzuarit."*

79. Gjykata vlerëson se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje procedurale për shkak se prokuroria dhe gjykatat e rregullta nuk ia dhanë mundësinë mbrojtësit të tij që të deklarohet për aktakuzën e ndryshuar dhe të zgjeruar kundër tij, nuk shpalos shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (3) (a) të KEDNJ-së.

(ii) Përkitazi me pretendimin për shkelje të të drejtave të mbrojtjes së parashtruesit të kërkesës (neni 31 i Kushtetutës, neni 6-3-a i KEDNJ-së, neni 61.3 i KPPRK-së)

80. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 (3) (a) të KEDNJ-së dhe duke iu referuar nenit 61, paragrafi 3 [Të drejtat e mbrojtësit si përfaqësues i të pandehurit] të KPPRK-së sepse veprimet hetimore-marrja në pyetje e dëshmitarëve, palëve të dëmtuara, identifikimi i të akuzuarit-parashtruesit të kërkesës, janë kryer pa praninë e mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se Gjykata Themelore kishte sqaruar: *"Në lidhje me identifikimin e personit përmes fotografisë, gjykata konstatoi se ky identifikim është bërë në përputhje me dispozitën e nenit 120 të KPPK-së, që është dispozitë e veçantë që rregullon*

identifikimin e një personi apo gjësendi (sendi) dhe në asnjë nga paragrafët e nenit të përmendur nuk kërkohet dhe nuk është e domosdoshme prania e mbrojtësit. Mbrojtja e të pandehurit gabimisht i referohet dispozitës së nenit 61, paragrafi 3, e cila parasheh: mbrojtësi ka të drejtë të njoftohet me kohë për vendin dhe kohën e zbatimit të veprimeve hetimore, të marrë pjesë në to dhe të shikojë shkresat e lëndës dhe provat e çështjes në pajtim me dispozitat e këtij Kodi. Pra, kjo është një dispozitë e përgjithshme, e cila në pjesën e fundit konstaton se kjo e drejtë është në pajtim me dispozitat e kodit, që do të thotë se vetëm në rastet kur kjo është në mënyrë eksplicite e definuar me dispozitë konkrete, mbrojtësi e ka këtë të drejtë, p.sh. siç është përcaktuar në dispozitën e nenit 132, paragrafi 5, të KPPRK-së, me rastin e marrjes së deklaratës në procedurën paraprake, ndërsa neni 120 i KPPRK-së, nuk e parasheh një obligim të tillë."

81. Gjykata po ashtu vëren lidhur me dëshmitë e dëshmitarëve për identifikimin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit kishte arsyetuar: "*Dëshmitarë të ndryshëm të sipërmendur, në situata të caktuara të ngjarjeve ishin prezent, u ballafaquan dhe vërejtën të akuzuarin. Për më tepër deklarimet e dëshmitarëve janë specifike në raport me veçorit dhe karakteristikat tipike të akuzuarit si ngjyra e syve, fytyra, flokët, gjatësia trupore. Këto rrethana të marra ndaras tregojnë për të provuarit e faktit të pjesëmarrjes së të akuzuarit në ngjarjet kriminale, këto dëshmi të ndërlidhura në unitetin e tyre plotësohen mes vete, japin një pasqyre te plote dhe provojnë ne mënyrë të padyshimtë pjesëmarrjen, rolin dhe kontributin e të akuzuarit në kryerjen veprave penale për të cilën akuzohet. Për rrjedhojë identifikimi nga një numër i dëshmitarëve me përshkrimet specifike të tipareve të akuzuarit, në rrethanat e ndryshme të ngjarjeve inkriminuese tregon për një identifikim real dhe të sigurt. Prandaj, mund të konkludohet se kuantumi i tërësishëm i fakteve dhe informatave të drejtpërdrejta të ofruara paraqet material të mjaftueshëm provues dhe identifikues, si i tillë mund të shërbej për një përfundim të qartë dhe të saktë për përgjegjësinë penale të akuzuarit si rezultat i pjesëmarrjes në formën e bashkëkryerjes me persona tjerë në kryerjen e veprave penale siç përshkruhen ne aktgjykim për të cilat është shpallur fajtor."*

82. Gjykata po ashtu vëren se Gjykata Supreme lidhur me identifikimin e parashtruesit të kërkesës dhe pjesëmarrjes së mbrojtjes në veprimet hetimore, kishte arsyetuar: "*Në këtë aspekt gjykata e shkallës së parë në kuadër të ngjarjes ka sqaruar dhe konkretizuar veprimet inkriminuese të ndërmarra në bazë të dëshmive të cilat i ka vlerësuar të besueshme pa cenuar thelbin e akuzës. Pra, në këtë aspekt gjykata e shkallës së parë me rastin e përcaktimit të saktësisë, vërtetësisë dhe besueshmërisë së dëshmisë së dëshmitarëve ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Me rastin e vlerësimit të dëshmisë së kësaj dëshmitare gjykata ka analizuar në detaje si ka mundur të bëjë identifikimin e të dënuarit. Në këtë kontekst është e rëndësishme epilogu i konstatimit përfundimtar sipas aktgjykimit, i akuzuari sipas aktakuzës ngarkohej se ka shtënë me armë kallashnikov duke e vrarë të ndjerin B, për të cilën trupi gjykues nuk e pranon ketë version të ngjarjes, dhe në aktgjykim ka konstatuar një version të ngjarjes që është ma favorizues për të dënuarin, përkatësisht se në të ndjerin ka shtënë një pjesëtar i grupit të armatosur, prandaj në tërësinë e saj nuk i është vështirësuar gjendja në raport me vëllimin inkriminues që është akuzuar sipas aktakuzës së ndryshuar dhe zgjeruar. Gjykata Supreme vlerëson, se pretendimi në kërkesë për mos informimin e mbrojtësit për të marrë pjesë në veprime hetimore apriori nuk e bënë provën të jetë e papranueshme, pasi që mbrojtja e kishte mundësinë për ta kundërshtuar ligjshmërinë dhe t'i vë në diskutim provat e siguruara gjatë veprimeve të caktuara hetimore gjatë fazave të mëtutjeshme të procedurës penale, shkelja e tillë duhet të vlerësohet në kontekstin e ndikimit në rregullsinë dhe ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe në rastin konkret kjo nuk paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale."*

83. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës në kuptim të nenit 61.3 të KPPRK-së më shumë është mos pajtim i tij me interpretimin e dhënë nga e rregullta dhe si i tillë është çështje e ligjshmërisë.

84. Gjykata vlerëson se pretendimi i parashtruesit të kërkesës lidhur me nenin 61.3 të KPPRK-së, është çështje e ligjshmërisë dhe nuk shpalos shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (3) (a) të KEDNJ-së.

(iii) *Përkitazi me pretendimin për dëgjim të dëshmitarëve të rinj (neni 31 i Kushtetutës, neni 6-3-d i KEDNJ-së, neni 288.2 i KPPRK-së) –ballafaqimi si koncept*

85. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 (3) d) të KEDNJ-së duke iu referuar nenit 288, paragrafi 2 i KPPRK-së, sepse propozimi i dëshmitarëve të rinj mund të pranohet vetëm nëse dëshmitarët e propozuar nuk janë njohur në kohën e mbajtjes së shqyrtimit të dytë fillestar, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit kishte sqaruar: *"**(i)** pretendimi ankimor se ekziston shkelje e dispozitës së nenit 288 par.2 të KPPRK-së, është i pabazuar pasi paragrafi 1, i dispozitës së cituar, lejon palët, mbrojtësin dhe të dëmtuarin edhe pas caktimit të shqyrtimit kryesor mund të kërkojnë që në shqyrtim kryesor të thirren dëshmitarë dhe ekspertë të rinj ose të mblidhen prova të reja; **(ii)** për më tepër është fakt që dispozita e nenit 288 par. 2 të KPPRK-së kujdeset në mënyrë të veçantë, për të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë, në mënyrë që të mos cenohet në rast të refuzimit të provës së propozuar, por nuk nënkupton se propozimet nga palët dhe të dëmtuarit për dëgjimin e dëshmitarëve dhe provave të reja duhet të jenë vetëm në favor të akuzuarit-parashtruesit të kërkesës.";*

86. Gjykata po ashtu vëren se për të njëjtin pretendim, Gjykata Supreme kishte ritheksuar: *"Neni 288 par.1 i KPPK-së, lejon palët, mbrojtësin dhe të dëmtuarin edhe pas caktimit të shqyrtimit kryesor mund të kërkojnë që në shqyrtimin kryesor të thirren dëshmitarë dhe ekspertë të rinj ose të mblidhen prova të reja, e jo siç pa të drejtë pretendon parashtruesi i kërkesës se në rastin konkret kjo do të vlente vetëm për parashtruesin e kërkesës dhe assesi për palën e dëmtuar. Gjykata Supreme vlerëson, se pretendimi në kërkesë për mos informimin e mbrojtësit për të marrë pjesë në veprime hetimore apriori nuk e bënë provën të jetë e papranueshme, pasi që mbrojtja e kishte mundësinë për ta kundërshtuar ligjshmërinë dhe t'i vë në diskutim provat e siguruara gjatë veprimeve të caktuara hetimore gjatë fazave të mëtutjeshme të procedurës penale, shkelja e tillë duhet të vlerësohet në kontekstin e ndikimit në rregullsinë dhe ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe në rastin konkret kjo nuk paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale."*

87. Gjykata vlerëson se edhe pretendimi i parashtruesit të kërkesës për interpretim dhe zbatim të nenit 288.1 të KPPRK-së më shumë është mos pajtim i tij për mënyrën sesi gjykatat e rregullta kanë interpretuar dhe zbatuar nenin në fjalë dhe si e tillë është çështje e ligjshmërisë. Veç kësaj, Gjykata rithekson se pranueshmëria e dëshmive është çështje që rregullohet me ligj vendor dhe gjykatat e rregullta dhe se shqetësimi *(concern)* i vetëm i Gjykatës nën nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (1) dhe 3 (d) të KEDNJ-së është që të hetojë *(examine)* nëse procedurat janë administruar me korrektësi (shih rastin e GJEDNJ-së, *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 118).

88. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta nuk kanë mohuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për të propozuar dëshmitarë të rinj, veçse të njëjtat kanë theksuar se propozimi i dëshmitarëve vlen edhe për palët e dëmtuara, çka është në pajtim me barazinë e plotë e armëve të palëve në çështje penale ashtu siç garantohet me

nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6-3-d të KEDNJ-së (shih rastet e GJEDNJ-së, *Perna kundër Italisë*, cituar më lart, paragrafi 29; *Murtazaliyeva kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafi 139; dhe *Solakov kundër ish Republikë Jugosllave të Maqedonisë*, cituar më lart, paragrafi 57).

89. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se nuk rezulton se procedurat nuk janë administruar me korrektësi dhe se zhvillimi i tyre nuk shpalos shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (3) d) të KEDNJ-së.

(iv) *Përkitazi me pretendimin për dëgjim të dëshmitarëve në favor të parashtruesit të kërkesës (neni 31 i Kushtetutës, neni 6-3-d i KEDNJ-së) – Barazia e armëve*

90. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 (3) d) të KEDNJ-së sepse gjykatat nuk kanë dëgjuar dëshmitarët që do të kishin dëshmuar në favor të parashtruesit të kërkesës ose të paktën dëshmia e tyre do të ishte neutrale, Gjykata vëren se Gjykata Themelore kishte dëgjuar dëshmitë e dëshmitarëve S.M., dhe I. Ç, të cilët kishin deklaruar në **favor të alibisë** së parashtruesit të kërkesës që në ditën kritike të kryerjes së veprave penale, parashtruesi i kërkesës kishte qenë në Beograd dhe jo në Pejë, pra, në vendin ku kishin ndodhur krimet që akuza ia kishte ngarkuar parashtruesit të kërkesës.

91. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson që sa i përket administrimit të drejtë të drejtësisë është shumë domethënëse që gjykatat i kanë dëgjuar edhe dëshmitarët në favor të parashtruesit të kërkesës, ndërsa pesha që u akordohet dëshmisë së atyre dëshmitarëve është çështje e juridiksionit dhe fushëveprimit të gjykatave të rregullta, të cilat Gjykata-bazuar në parimin e subsidiaritetit-nuk mund t'i zëvendësojë me vlerësimin e vet.

92. Gjykata rithekson se neni 31 i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (3) (d) të KEDNJ-së nuk i akordon parashtruesit të kërkesës të drejtë të pakufizuar për të siguruar paraqitjen e dëshmitarëve në gjykatë. Zakonisht u takon gjykatave të rregullta për të vendosur nëse është e nevojshme apo e kështillueshme që të merret në pyetje një dëshmitar (shih rastin e GJEDNJ-së, *S.N. kundër Suedisë*, cituar më lart, paragrafi 44).

93. Përkitazi me fuqinë provuese të dëshmitarëve të thirrur në favor të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore kishte konstatuar: "*Mbrojtja e të pandehurit lidhur me alibinë e tij, së pari nuk është e saktë në aspektin e hapësirës kohore, pra ka pasur ndryshime me kalimin e kohës, ajo është e palogjikshme, nuk mbështetet në prova materiale, ndërsa dëshmitë e dëshmitarëve S.M., dhe I.Ç., nuk janë të besueshme për gjykatën sepse ato nuk kanë asnjë mbështetje në asnjë provë tjetër, por janë në kundërshtim me dëshmitë e dëshmitarëve F.Sh., S.T., dhe B.M., dhe janë gjithashtu në kundërshtim edhe me dëshmitë e dëshmitarëve A.N., dhe të gjithë dëshmitarëve të cilët e kanë identifikuar të akuzuarin si pjesëmarrës në krim.*"

94. Në këtë kontekst, Gjykata e Apelit kishte vërtetuar: "*Dëshmitari S.T., dhe dëshmitari F. Sh., konfirmojnë prezencën e të akuzuarit në ditët e zhvillimit të ngjarjeve, të njëjtit të akuzuarin e njiheshin pasi kishin punuar se bashku si personel i misionit vëzhgues se OSBE në Pejë. Prezencën e të pandehurit në Pejë në atë kohë e konfirmon edhe fqinja e tij B.M., të cilat dëshmi së bashku hedhin poshtë alibinë e të akuzuarit se në kohën kur janë kryer këto krime ka qenë në Beograd të Republikës së Serbisë për studime. Se i akuzuari ka qenë pjesëtar i policisë rezervë e dëshmon prova materiale kopja e listës së 03.06.1999, e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme – Sekretariati në Pejë nga Komandanti i Stacionit Policor Major – M. Stojanoviq. Ndërsa se nuk kemi të bëjmë me një person tjetër me emër dhe mbiemër të njëjtë e vërteton prova materiale*

dëshmia e siguruar nga burimet e hapura që Ministria e Punëve të Brendshme në vitin 1999 kishte publikuar pjesëtar policor të vrarë në vitin 1998 në Kosovë."

95. Gjykata Supreme po ashtu kishte vërtetuar: "*Siç rezulton nga shkresat e çështjes, aktgjykimet e kundërshtuara si tërësi, pra edhe dispozitivat e të njëjtëve janë të qartë, të kuptueshëm dhe nuk përmbajnë kundërthënie me vetvete ose me arsyet e paraqitura. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare duke vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse si dhe arsyet ku është bazuar me rastin e vendosjes së kësaj çështje penalo-juridike, e sidomos me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale. Gjykata e shkallës së parë vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat ligjore, duke paraqitur në mënyrë të qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i merr si të provuara ose si të paprovuara, gjithashtu ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale. Pra, të dy aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, nuk përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, janë të qëndrueshme juridikisht, rrethanat e paraqitura në aktgjykime janë të qarta dhe në përputhje me dispozitat ligjore që i nënshtrohen saktësisht veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor. Në këtë aspekt gjykata e shkallës së parë në kuadër të ngjarjes ka sqaruar dhe konkretizuar veprimet inkriminuese të ndërmarra në bazë të dëshmive të cilat i ka vlerësuar të besueshme pa cenuar thelbin e akuzës. Pra, në këtë aspekt gjykata e shkallës së parë me rastin e përcaktimit të saktësisë, vërtetësisë dhe besueshmërisë së dëshmisë së dëshmitarëve ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse të cilat i pranon edhe kjo gjykatë."*

96. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të garancive procedurale për shkak se gjykatat nuk kanë dëgjuar dëshmitarët që do të kishin dëshmuar në favor të parashtruesit të kërkesës, nuk shpalos shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (3) (d) të KEDNJ-së.

Përfundim

97. Si përfundim të analizës së mësipërme dhe në vlerësim të tërësishëm të procesit penal kundër parashtruesit të kërkesës, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta: **(i)** kanë shpjeguar se me zgjerimin e aktakuzës nuk është ri-kualifikuar vepra penale e as nuk është rënduar pozita e parashtruesit të kërkesës si i akuzuar; **(ii)** kanë respektuar të drejtat e mbrojtjes gjatë zhvillimit të procesit penal; **(iii)** kanë adresuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës për dëgjimin e dëshmitarëve të rinj; dhe, **(iv)** kanë respektuar parimin e barazisë së armëve duke dëgjuar dëshmitarët në favor dhe kundër parashtruesit të kërkesës.

98. Gjykata vlerëson se garancitë specifike të nenit 6 (3) ilustrojnë nocionin e gjykimit të drejtë lidhur me situatat tipike procedurale që paraqiten në rastet penale, por që qëllimi thelbësor i tyre është që të kontribuojnë në sigurimin e drejtësisë së procedurës penale si tërësi. Prandaj, garancitë e mishëruara në nenin 6 (3) nuk janë qëllim në vetvete, dhe që duhet të interpretohen duke pasur parasysh funksionin që ato kanë në kontekst të zhvillimit të procedurave si tërësi (shih rastet e GJEDNJ-së, *Ibrahim dhe tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 50541/08 50571/08 50573/08 40351/09 Aktgjykim i 13 shtatorit 2016, paragrafi 251; dhe *Mayzit kundër Rusisë*, nr. 63378/00 Aktgjykim i 20 janarit 2005, paragrafi 77).

99. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se zhvillimi i këtij procesi penal në tërësi nuk shpalos shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (3) (a) dhe (d) të KEDNJ-së.

100. Gjykata po ashtu konsideron se pretendimi për shkelje të nenit 9 (2) të KNDCP-së nuk mund të jetë objekt i vlerësimit kushtetues, për shkak se i njëjti nuk ngre ndonjë çështje të re që nuk është shqyrtuar në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (3) (a) dhe (d) të KEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës nr. KI65/15, parashtrues *Tatjana Davila, Ljubiša Marić, Zorica Kršenković, Zlatoj Jevtić,* Aktgjykim i 14 shtatorit 2016; dhe nr. KI193/18, parashtrues *Agron Vula*, Aktgjykim i 22 prillit 2020).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 nëntor 2023,

VENDOS

I. TA DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, me shtatë (7) vota për dhe një (1) kundër, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [Pml.nr.19/2022] i 5 shkurtit 2022, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit [APS.nr.22/2021] i 12 tetorit 2021; Aktgjykimi i Gjykatës Themelore [ST.nr.15/19] i 11 shkurtit 2021, në këtë çështje penale, nuk janë në kundërshtim me paragrafët 1,2 dhe 4 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 (3) (a), (b) dhe (d) (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, t'a publikojë në Gazetën Zyrtare;

IV. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 20 (5) të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi Gresa Caka-Nimani